NR. 45, NENTOR 2025 | Viti IV

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



## EKSKLUZIVE

AMBASADORI I UKRAINËS NË SHQIPËRI

## Volodymyr Shkurov: "Paqja është qëllimi, por jo paqe me çdo çmim"

- Bota midis luftës dhe paqes – Kina dhe SHBA në koalicionin për paqe!

- Rusia, Kosova dhe Ukraina dhe modeli i rremë i "precedentit"

- Serwer: T'i thuash "jo" Trumpit është thelbësore

ARGUMENTUM
news opinion analysis

**Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,**

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revistën Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**“Argumentum”, një proces intelektual …**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 JO VETEM LAJM**
- Shqipëria feston shpalljen e Pavarësisë, 113 vite nga ngritja e flamurit në Vlorë.

**05 OP/ED**
- Bota midis luftës dhe paqes – Kina dhe SHBA në koalicionin për paqe!

**08 FOKUS**
- Rusia, Kosova dhe Ukraina dhe modeli i rremë i “precedentit”.
- Serwer: T’i thuash “jo” Trumpit është thelbësore.

**11 INTERVISTA**
- EKSKLUZIVE / Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov: “Paqja është qëllimi, por jo paqe me çdo çmim”.

**17 REALPOLITIK**
- Armëpushim tregtar! Raporte progresi apo Regresi? ”Malorja” e negociatave 2027! Paqe, jo pushtim dhe kapitullim!

**19 POLITIKË**
- Rama dhe Kos pas Samitit të Planit të Rritjes: Integrimi po përshpejtohet, debati politik fokus te drejtësia dhe rasti Balluku.

**21 RAJONI**
- 30-vjetori i Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit që i dha fund luftës në Bosnjë e Hercegovinë.
- Diplomati amerikan Christopher Hill dëshmon në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

**24 BOTA**
- Papa Leo: Takim me Islamin në Turqi e Liban.

*ENGLISH EDITION*

**26 TOP NEWS**
- Growth Plan ‘Our Pathway to the EU’: Western Balkans Leaders Advance Regional Integration in Tirana.

**28 INTERVIEW**
- EXCLUSIVE / Ukrainian Ambassador to Albania, Volodymyr Shkurov: “Ukraine wants peace, but not at the expense of its freedom and independence”.

**30 REALPOLITIK**
- A trade ceasefire! Progress or regress reports? The mountainous road of negotiations 2027! Peace, not occupation and surrender for Ukraine!

# Shqipëria feston shpalljen e Pavarësisë



## 113 vite nga ngritja e flamurit në Vlorë



> **Me një zâ venduan që Shqipëria të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme"**

Më 28 Nëntor 1912, Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë.

28 Nëntori është dita më domethënëse për shqiptarët, që rikujton shpalljen historike të Pavarësisë së Shqipërisë më 1912. Kjo ditë simbolizon unitetin kombëtar dhe krenarinë për rrugëtimin drejt lirisë. Sot Shqiptarët, kudo ku ndodhen, festojnë sot 113-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë.

Më 28 Nëntor 1912, Kuvendi Kombëtar i Vlorës, i kryesuar nga Ismail Qemali, shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Ky akt ishte kurorëzimi i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe ngritjen e një shteti të pavarur shqiptar.

Në shpalljen e Pavarësisë morën pjesë 83 delegatë nga të gjitha trevat shqiptare, por 40 ishin firmëtarët që nënshkruan Aktin e Pavarësisë.

28 nëntori i vitit 1912 u quajt si "Nëntori i dytë" pasi më 28 Nëntor 1443, Heroi Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu çliroi Krujën nga pushtimi osman dhe ngriti flamurin mbi kalanë e saj.

Më 28 Nëntor 1912, Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë, duke deklaruar në Vlorë: "Me një zâ venduan që Shqipëria të bâhet në vehte, e lirë e e mosvarme".

Ismail Qemali ishte nisur që më 19 nëntor nga Triestja drejt brigjeve të Shqipërisë për të shpallur pavarësinë. Më 21 nëntor, zbarkoi në Durrës prej vaporit të Llojdit austriak "Baron Bruck". Në këtë qytet u prit në qelën e Dom Nikollë Kacorrit, i cili do të ishte pas një jave edhe zëvendëskryeministri i parë i qeverisë së 28 Nëntorit. Sipas letërkëmbimit mes Eqrem Bej Vlorës dhe Mustafa Krujës, ngritja e flamurit ishte menduar të bëhej më 22 nëntor në Durrës, me qëllim parandalimin e përparimit të mëtejshëm të ushtrive pushtuese në territorin e vendit. Por, për shkak të gjendjes së nderë në qytet, Ismail Qemali lajmëroi telegrafisht delegatët nga mbarë vendi që të drejtoheshin për në qytetin e tij të lindjes, në Vlorë.



Ndërkohë që forcat serbe përparonin me shpejtësi drejt Shqipërisë së Mesme, rrethet patriotike të Elbasanit (25 nëntor), të Tiranës e Durrësit (26 nëntor), të Kavajës, të Peqinit dhe të Lushnjës (27 nëntor), ngritën flamurin kombëtar, pa pritur mbledhjen e Kuvendit të Vlorës.

Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës.

28 Nëntori i vitit 1912 shënoi dhënien fund të sundimit gati pesëshekullor të Perandorisë Osmane dhe njëkohësisht krijoi kushte të reja politike për zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor.

Data 28 nëntor përsëritet në historinë e Shqipërisë edhe në raste të tjera si fillimi i transmetimeve të Radio Tirana më 28 nëntor 1938 dhe datëlindja e heroit legjendar, Adem Jashari më 28 nëntor 1955.

Ndërkohë, prej vitit 2017, 28 Nëntori është shpallur feste zyrtare edhe në Kosovë. Kryeministri i atëhershëm Ramush Haradinaj e shpalli ditë pushimi në territorin e Republikës së Kosovës duke thënë se, kjo do të ishte Dita e Shqiptarëve, në respekt të vlerave të trungut etnik shqiptar si dhe traditave të mira familjare e shoqërore.

# BOTA MIDIS LUFTËS DHE PAQES

# Kina dhe SHBA në koalicionin për paqe!





Prof. Dr. Enver Bytyçi

> **KASH nxit politikën shqiptare dhe i bën thirrje të gjitha vendeve anëtare të NATO-s e BE që të shprehin solidaritet të plotë me Poloninë, vendet balltike, por edhe vende të tjera në kufi me Ukrainën që janë dëmtuar nga inkursionet e herë pas hetshme ushtarake ruse, të forcojnë unitetin midis tyre dhe të rrisin gadishmërinë ushtarake për tiu kundërvënë çdo provokacioni të rezikshëm rus që dëmton paqen dhe stabilitetin në kontinent e më gjerë.**

Para pak ditësh në Korenë e Jugut u bë takimi midis dy liderëve më të fuqishëm të globit, atij amerikan, Donald Trump dhe presidentit kinez, Xi Jinping. Në atë takim u mor vesh se tarifat amerikane për mallrat kineze që eksportohen në SHBA ishin mjet pët ta bindur presidentin e Republikës Popullore të Kinës që ai të ndihëmonte në zgjidhjen e konfliktit midis Rusisë dhe Ukrainës. Dihet se Pekini dhe Moska kanë tashmë një partneritet dhe aleancë të shpallur, por që deri më sot ka rezultuar të jetë efektive në fushën e politikës, ekonomisë, infrastrukturës etj. Lufta në Ukrainë nuk është përkrahur nga ana e liderëve kinezë, së paku në masën që kishte shpresuar Moska.

Në të vërtetë Xi Jinping e dinte këtë lloj loje. Ai kishte qenë gjithmonë I gatshëm për të dhënë kontributin e tij për përfundimin e luftës në Ukrainë, pavarësisht lidhjeve të ngushta me Putin. Ishte presidenti kinez ai që ndaloi retorikën e Vladimir Putin për kërcënimin me përdorimin e armëvë bërthamore të para dy viteve. Që do të thotë së Kina nuk u bë direkt palë në anën e Rusisë në këtë konflikt. Edhe vetë Volodymyr Zelensky shprehu disa herë shpresën dhe dëshirën që Kina të ndihëmonte për t'i dhënë fund luftës. Madje ai i kërkoi Kinës të bëhej ndërmjetëse e bisedimeve për përfundimin e këyij konflikti shkatërrues. Dhe Pekini e bëri këtë thuajse nga dita e parë e agresionit me shumë kujdes dhe me shumë durim. Pa ngutje. Pa presione. Pa mburrje! Deri te deklarata se duhet të respektohet sovraniteti tokësor i Ukrainës.

Ndërkohë presidenti Trump ia përsëriti homologut të tij kinez, Xi, kërkesën që të ndërmjetësojë paqen në Ukrainë. Kjo do të thotë

se paqja ose lufta varen nga dy më të mëdhenjtë e planetit, SHBA dhe Kina. Kurse presidenti i Koresë së Jugut i kërkoi homologut të tij kinez që të ndërmjetësojë për një marrëdhënie paqësore me Korenë e Veriut. E në harkun k0hor të tri ditëve, sërishmi presidenti Xi bën një hap tjetër drejt paqes me Japoninë. Takoi dhe bisedoi me kryeministren e re të Japonisë, konservatoren Sanae Takaichi.

Në pak ditë ka kaq shumë dëshmi se Pekini është i përkushtuar për paqe dhe se roli i tij në botë është i pazevendësueshëm. Dhe kur të gjithë duan të punojnë me Kinën, atëherë do të thotë se superfuqia aziatike ka në dorë të bëjë gjëra të mëdha. A mund ta zhgënjejë Pekini shpresën për paqe të njerëzimit? Do të ishte gabim, nëse ndodh e kundërta. Por unë besoj se jo. Liderdshipi kinez ka provuar se nuk zhgënjen. Autoriteti i saj nuk bazohet aq në fuqinë politike, ekonomike, demografike dhe ushtarake e teknologjike të saj, sa në respektimin e parimeve të barazisë midis shteteve dhe të ligjit ndërkombëtar për rendin botëror.

Megjithatë bota ndodhet ende midis dilemës për konflikte deri në shpërthimin e Luftës së Tretë Botërore dhe shpresës për paqe. Kurrë ndonjëherë pas Luftës së Dytë Botërore nuk është folur kaq shumë për luftën dhe paqen, si dy koncepte të kundërta, me të cilat mund të përballet njerëzimi. Nga njëra anë Rusia dhe Izraeli, të cilat kryejnë agresione dhe vrasin njerëz të pafajshëm. Nga ana tjetër SHBA-të, Kina dhe vende të tjera, të cilat po përpiqen për paqen. Dy pamje të ndryshme. Dy realitete me të cilat gati sa u mësuam t'I shohim si normalitet.

> **Gjatë këtij viti bota ka shënuar disa momente historike në dramat dhe përpjekjet për t'i shëruar ato. Plagët e luftës që u hapën kërcënojnë rendin, stabilitetin dhe rregullin ligjor ndërkombëtar. Donald Trump duket qartë se dëshiron t'I shërojë këto plagë. Ai erdhi në në janar në Shtëpinë e Bardhë gjithnjë me shpresën se do të bëjë paqe në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme. Pati premtuar se do ta sillte paqen në Ukrainë brenda një kohe të shkurtër. Për këtë ndërtoi skemën e bisedimeve dhe ngarkoi diplomatë të fuqishëm.**

Gjatë këtij viti bota ka shënuar disa momente historike në dramat dhe përpjekjet për t'i shëruar ato. Plagët e luftës që u hapën kërcënojnë rendin, stabilitetin dhe rregullin ligjor ndërkombëtar. Donald Trump duket qartë se dëshiron t'I shërojë këto plagë. Ai erdhi në në janar në Shtëpinë e Bardhë gjithnjë me shpresën se do të bëjë paqe në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme. Pati premtuar se do ta sillte paqen në Ukrainë brenda një kohe të shkurtër. Për këtë ndërtoi skemën e bisedimeve dhe ngarkoi diplomatë të fuqishëm. Para pak javësh priti për bisedime në Alaska presidentin rus, Vladimir Putin. Më pas përdori një sërë mjetesh për të imponuar paqen, deri te kërcënimet me sanskione. U bëri presion Indisë dhe Kinës që të ndërpresin furnizimin me naftë dhe gaz nga Rusia. Këtë presion ua bëri edhe vendeve të Europës dhe atyre anëtare të NATO-s. Kështu në një dorë mbajti kulaçin e në anën tjetër përdori presionin. Por pavarësisht kësaj Vladimir Putin i ka bërë bisht deri më sot përfundimit të luftës në Ukrainë. Madje ka intensifikuar sulmet ushtarake dhe shtuan numrin e viktimave të pafajshme në Ukrainë.

Tani, pas 10 muajve të ardhjes në pushtet të presidentit Trump shohim se ka arritur së paku një lloj armëpushimi në Gaza, pavarësisht se ky armëpushim nuk po respektohet. Ka realizuar nënshkrimin e marrëveshjeve të paqes midis Azerbajxhanit dhge Armenisë, si dhe së fundmi atë midis Kamboxhias dhe Tajlandës. Ka mundur që të ndalojë një konflikt të mundshëm midis Pakistanit dhe Indisë. Po ashtu ka kërcënuar Serbinë, me qëllim që ajo të mos mund të ndërmarrë ndonjë aventurë lufte e konflikti në Kosovë. Në një farë mënyre Donald Trump bëri që Izraeli të ndalë luftën kundër Iranit dhe e qortoi Tel Avivin për sulmet e tij ushtarake kundë Katarit. Ndërkaq faktorizoi Turqinë në Lindjen e Mesme, si fuqinë më të madhe të rajonit midis Europës dhe Azisë, pas Rusisë, e cila nuk është në trenin e paqes.

Në këto përpjekje Trump tërhoqi Turqinë në anën e tij dhe vendosi disa ekuilibre me shtetet e fuqishme të Europës, sidomos me Britaninë e Madhe dhe Gjermaninë. Turqia dhe presidenti i saj, Rexhep Tayp Erdogan, u bënë pika e rëndesës në orientimin e zotit Trump për të sjellë paqen në Lindjen e Mesme. Të gjitha këto lëvizje kanë shkuar në drejtimin e krijimit të një koalicioni të madh të paqes. Duket qartë se ky



koalicion do ta vendosë në pozitë të vështirë presidentin rus, Vladimir Putin.

Kurse gjatë turit të tij në Azi Trump u përpoq sërishmi të bëjë të njëjtën gjë, të zgjerojë koalicionin anti-luftë, që do të thotë anti-Rusi. Pak a shumë u mor vesh edhe me presidentin kinez, Xi Jinping. Reduktoi tarifat doganore për mallrat kineze, të cilat hyjnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në këmbim të kontributit të Pekinit për paqen. Deri diku ia arriti qëllimit, sepse me shumë gjasa e ka ankoruar më aktivisht Pekinin pro paqes.

Ndërkohë që kur nisi sulmi ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës, mediet perendimore kanë artikuluar dhe projektuar vazhdimisht atë se tani "Edhe Kina do ta sulmojë dhe aneksojë Tajvanin"! Por kjo nuk ndodhi, megjithëse Tajvani nuk është subjekt i të drejtës sovrane ndërkombëtare, sepse nuk është anëtar i OKB-së. Ukraina po. Ajo është subjekt shtetëror ndërkombëtar së bashku me territorin e Krimesë dhe e njohur në OKB. Pse Kina nuk ndërmori ndonjë aventurë ushtarake në Tajvan? Së pari, sepse ajo i përmbahet zgjidhjeve paqësore dhe me dialog të konflikteve dhe të së drejtës. Nëse do të ndërmerrte një sulm ushtarak kundër Tajvanit, atëherë predikimi i saj moral për paqen nuk do të kishte vlerë. Vendet e vogla dhe aleate të saj do ta humbisnin besimin se Kina i përmbahet parimeve dhe zotimeve që ajo merr. Por edhe se Kina e di që një sulm kundër Tajvanit në kushtet e luftës në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme do të çonte në pragun e një lufte të përbotëshme. Ajo është kundër Luftës së Tretë Botërore. Ndaj dhe i përgjigjet në formën e saj bashkimit në koalicionin e paqes. Në këtë kuptim, Donald Trump ka të drejtë kur thotë se "Kina nuk do ta sulmojë Tajvanin" gjatë mandatit të tij presidencial. Në fakt Kina nuk do ta sulmojë ishullin në fjalë as gjatë kohës së Trump, as pas tij. Jo se, siç thotë presidenti amerikan, "Xi i di pasojat, nëse sulmon Tajvanin". Por se Pekini ndjek strategjinë që Tajvani t'i bashkohet Kinës vullnetarisht e paqësisht. Dhe sa kohë që ky ishull nuk do të jetë subjekt i së drejtës sovrane ndërkombëtare, në Tajvan do të ketë forca politike, siç është sot opozita e këtij vendi, që do të proklamojnë bashkimin e ishullit me Republikën Popullore të Kinës.

Ndërkohë sipërmarrësit tajvanezë sot që po shkruajmë kanë investuar në Kinë një kapital prej 400 miliard dollarësh amerikanë. A mundet që biznesi i një vendi të caktuar të investojë kaq shumë kapital në një vend fqinjë, i cili na qenka kaq armiqësor, sa e bëjmë ne Kinën për Tajvanin?! Absurde ta mendosh. Përkundrazi, kjo është shenjë e qartë se nëse ndodh bashkimi i Tajvanit me Kinën dhe kjo do të ndodhë një ditë, ky bashkim do të bëhet në mënyrë paqësore, sipas kritereve ndërkombëtare. Dhe nëse i përmbahemi logjikës raicionale, atëherë rezultati do të jetë i tillë.

Pas gjithë kësaj panorama, mund të themi se paqja në botë varet nga marrëdhëniet kino-amerikane. Një mirëkuptim dhe bashkërendim I veprimeve për paqen nga ana e Uashingtonit dhe Pekinit do ta bëjë botën stabile, të qëndrueshme dhe shumë më të sigurt. Thjesht duhet dialog dhe respekt për interesat e ndërsjellta të të dy vendeve.

# Rusia, Kosova dhe Ukraina dhe modeli i rremë i “precedentit”

Thellimi i dështimit të mbroj- tjes së veprimeve agresive e joligjore të Rusisë kundër Ukrainës, fqinjëve të saj e më gjerë, është duke e bërë këtë vend të madh territorialisht (Rusinë) që ta humbë betejën e narrativave në Kosovë.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen ka deklaruar se kufijtë nuk mund të ndryshohen me forcë, duke kundërshtuar çfarëdo ndryshimi të tillë në Ukrainë.

Rusia, e cila nga studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të gjeopolitikës, është një fuqi që dobësohet nëse nuk zgjerohet vazhdimisht, duke mos mbetur as fuqi e dorës së tretë, gjë që e ka pranuar edhe vet Aleksandër Dugin, vazhdimisht ngelet te përpjekja që ta shfrytëzojë Kosovën si “precedent” për legjitimimin e veprimeve të saj agresore.

Mirëpo, ky territor i madh që quhet Rusi, po e humb betejën me Kosovën, për shkak të falsitetit të narrativës së saj.



Autor: Dr. Gurakuç Kuçi – Hulumtues i Lartë në Institutin për Studime të Luftës Hibride “OCTOOPUS” dhe profesor në Kolegjin UNI

### Nga 1877 te 1999: Si u zgjerua Serbia me forcë dhe pse pretendimi i Zaharovës është fals

Maria Zaharova, zëdhënëse e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, në reagimin ndaj von der Leyen e përmend rastin e Kosovës, duke thënë se: “Ishte Perëndimi ai që deklaroi dhe zbatoi me forcë ripërcaktimin e njëanshëm të kufijve të Serbisë, në kundërshtim me vullnetin e popullit serb”.

Fatkeqësi e madhe për këtë territor të madh si Rusia të udhëhiqet nga njerëz të cilët tashmë mundohen edhe gënjeshtrën ta mashtrojnë.

Kosova nuk i është marrë me forcë askujt!

Që nga 1877 kur Kosova kishte 22.900 km2, është Serbia e përkrahur nga Rusia që është zgjeruar në dëm të trojeve shqiptare, duke pushtuar territore dhe shpërngulur e kryer gjenocid mbi shqiptarët. Territori i sotëm i Kosovës akoma strehon shumë shqiptarë nga rajonet e pushtuara si Nishi, ku hyjnë Toplica, Prokuplja, Kurshumlija, Leskovci, Vranja, pastaj Sanxhaku i Novi Pazarit, e deri tek pjesa ku është Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.

Ka qindra e mijëra dëshmi të botuara se si rajonin e Kosovës së sotme nga 1918 e ka kolonizuar Serbia dhe nga arkivat e Serbisë janë nxjerrë me emra, mbiemra dhe adresat në Kosovë ku janë vendosur kolonët serbë. Këtë mbledhje dhe publikim të dëshmive e ka bërë Millovan Obradoviç.

Në vitet ‘90 Kosova pësoi një terror të tmerrshëm nga Serbia, pas suprimimit të autonomisë, shqiptarëve iu mohua punësimi, shkollimi, shëndetësia, ndërsa dhuna sistematike, represioni e burgosjet, kulmuan me masakrat dhe gjenocidin gjatë viteve 1998-’99.

Kosova do të kishte pësuar një spastrim total etnik sipas operacionit “Patkoi” dhe një tragjedi akoma më të rëndë se sa Bosnja, po të mos ishte ndërhyrja humanitare e NATO-s që ta ndalonte dhunën e regjimit të egër




të Sllobodan Millosheviqit.
Vetëm disa statistika: për dy vite '98-'99 u deportuan mbi 800 mijë shqiptarë nga Kosova, u vranë dhe masakruan rreth 13-14 mijë civilë, u dhunuan më shumë se 19 mijë gra dhe vajza, u zhdukën mijëra trupa, prej të cilëve ende për rreth 1600 Serbia nuk tregon se ku i ka fshehur.
Pas luftës, në misionin paçebërës me NATO-n ka pasur edhe forca nga Rusia, nëpërmjet të cilave ajo provokoi hapur riballafaqimin me perëndimin.

### Pse argumenti rus për Kosovën dështon juridikisht, politikisht dhe strategjikisht

Pavarësisht çfarë thotë Zaharova e Rusia, secili njeri i pandikuar nga propaganda e pranon publikisht (pasi në mendje e di të vërtetën secili) se NATO nuk ka bërë agresion ndaj Serbisë. Përkundrazi, ajo e ka ndalur gjenocidin dhe madje e ka shpëtuar edhe vetë Serbinë nga kthetrat e njerëzve si Milloseviçi. Përkundrazi, është Rusia ajo që po e rikthen Serbinë te njerëzit e Milloshevigit, duke sponsorizuar proxy shtete dhe politikanë si Aleksander Vuçiq e Aleksander Vulini.
Për më tepër, nuk duhet harruar se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ishte Serbia, me ndihmën e Rusisë, që kërkoi mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. GJND-ja e dha gjykimin e saj dhe tani hipokrizia mbetet te Rusia dhe Serbia që nuk e pranojnë "përgjigjen" e pyetjes së tyre. GJND-ja konfirmoi se Kosova nuk e kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare me shpalljen e pavarësisë. Rusia dhe Serbia e kërkuan mendimin e saj, por athua s'do t'i bindeshin e do ta kundërshtonin edhe nëse gjykimi i GJND-së do të thoshte se Kosova e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare?
Zaharova e sulmon von der Leyen, sepse dëshiron që në pazaret për paqen në Ukrainë të përfitojë sa më shumë duke e shfrytëzuar Kosovën si "precedencë". Mirëpo, ky është një krahasim artificial dhe madje mashtrim për popullin serb, të cilit Rusia dhe regjimi i Vuçiqit ia ka errësuar edhe më shumë shikimin.
Duke e përmendur Kosovën si precedent, Rusia e ka syrin te pazaret kundër Ukrainës. Megjithatë, ajo duket se ka ngecur në grackën e narrativës kundër Kosovës dhe po e humb betejën me të drejtën.

# Serwer: T'i thuash "JO" Trumpit është thelbësore

DANIEL SERWER



Plani 28-pikësh rus i "paqes" që amerikanët po e kritikojnë është aq i keq sa ngurroj të komentoj për të. Të tjerë e kanë rrëzuar. Trump dëshiron t'i japë Moskës gjithçka që mund të shpresonte. Ata që shpresonin se Trump do të kishte ndryshuar drejtimin për Ukrainën gaboheshin. Është e vështirë të besohet se dikush do të imagjinonte se Presidenti Zelensky do të donte ta pranonte. Propozimi do t'i jepte territorin ukrainas Rusisë, do të kufizonte forcat e armatosura të Ukrainës dhe zgjedhjen e aleatëve të saj, dhe do të ofronte garanci boshe për sigurinë. Ai gjithashtu do të mandatonte një zgjedhje që Zelensky me siguri do t'i humbiste. Pa përmendur që plani amerikan (rus) shkel shumë ligje dhe norma ndërkombëtare (shih Eerik N. Kross për një trajtim të plotë).

**Cila është BATNA e tij?**

Por Zelensky do të duhet të luajë me të. Trump është konsistent në disa gjëra, por hakmarrja e tij është e garantuar. Një "jo" e prerë do të rrezikojë hakmarrje. Pyetja kritike për Zelensky është kjo: cila është alternativa e tij më e mirë ndaj një marrëveshjeje të negociuar? Kjo është ajo që ofron ndikim në një negociatë.

Trump ka ndaluar ndihmën ushtarake dhe ekonomike amerikane për Ukrainën. Evropianët po kompensojnë boshllëkun ekonomik, por pjesa ushtarake është më e vështirë. Ata nuk prodhojnë raketa Patriot. Dhe madje edhe për produktet e tyre, evropianët kanë kapacitet të kufizuar prodhimi. Mund të duhet shumë kohë për të marrë furnizime.

Dyshoj se më e rëndësishme është pjesa e inteligjencës. Trump po kërcënon edhe me këtë. SHBA-të kanë ofruar informacione mbi vendndodhjet dhe lëvizjet e trupave ruse, si dhe infrastrukturën brenda Rusisë. Pa këtë, sulmet e Kievit ndaj infrastrukturës së naftës dhe gazit pengohen, nëse nuk gjymtohen. Shpresoj që evropianët të mund të përmbushin nevojat e inteligjencës së Ukrainës.

KOHA KA RËNDËSI

Teoria e fitores së Kievit varet shumë nga shkatërrimi i infrastrukturës për të shkaktuar dhimbje ekonomike, e cila padyshim po rritet. Propozimi rus, sado i keq që është, është një shenjë se Moska po vuan. Kievi duhet të durojë derisa ekonomia ruse të shkatërrohet.

BATNA është pjesërisht një çështje kohe. Zelensky ka provuar se është mjeshtër i dredhive. Ai duket se po pranon një propozim humbës, por e kthen atë në diçka të pranueshme. Kjo është ajo që bëri me propozimin e parë shfrytëzues të Trump për një marrëveshje mineralesh. Por dredhia kërkon kohë. Trump po përpiqet ta privojë Zelenskyn nga opsioni dredhi duke këmbëngulur për një përgjigje deri të enjten e ardhshme.

Zelensky mund të pranojë të takohet me Presidentin Putin për të diskutuar propozimin. Kjo ka funksionuar vazhdimisht në të kaluarën, sepse Putini është tërhequr gjithmonë. Ai preferon luftën, në të cilën trupat e tij po ecin përpara. Por propozimi aktual është aq afër objektivave të tij saqë Putini mund të pranojë të takohet dhe t'ia atribuojë çdo dështim Zelenskyt. Nëse Putini ka sukses, ai mund të jetë i sigurt se Trump do ta ndëshkojë Ukrainën për çdo dështim të perceptuar.

**Miku i Amerikës merr më shumë presion**

Ukraina dëshiron të jetë mike e Amerikës, për të ndihmuar në forcimin e demokracisë së saj. Por të qenit mik i Amerikës do të thotë se është më e lehtë për Uashingtonin të të ushtrojë presion për rezultate të këqija. Zelensky duhet të bëjë gjithçka që mundet me miqtë e tjerë të Ukrainës në Evropë dhe Azi për të përmirësuar BATNA-n e tij. Thënia "jo" ndaj Trump është jetike për mbijetesën e Ukrainës.

EKSKLUZIVE / AMBASADORI I UKRAINËS NË SHQIPËRI, VOLODYMYR SHKUROV

# "PAQJA ËSHTË QËLLIMI, POR JO PAQE ME ÇDO ÇMIM"

*Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Ukrainës në Shqipëri, SHTZ. Volodymyr Shkurov*



Në një intervistë ekskluzive për *ARGUMENTUM.al*, Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov, flet hapur për sfidat ekzistenciale të vendit të tij në vitin e tretë të luftës me Rusinë, duke paralajmëruar se "paqja nuk mund të arrihet me çdo çmim".

Ai theksoi se, pavarësisht kushteve të jashtëzakonshme të konfliktit, Ukraina po vazhdon të mbrojë shtetin e vet dhe, njëkohësisht, po punon me këmbëngulje në nisma politike e diplomatike për krijimin e kushteve për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.

Përparimi në afrimin e Ukrainës drejt Bashkimit Evropian dhe forcimi i mbështetjes politike ndërkombëtare janë ndër arritjet më të rëndësishme të këtij viti. "Komisioni Evropian ka konstatuar arritje reale të Ukrainës në rrugën drejt anëtarësimit në BE," – theksoi Shkurov, duke shtuar se ky progres "na ngjall një farë optimizmi, pavarësisht sfidave të rënda të luftës."

Megjithatë, sfidat mbeten të mëdha. Ambasadori nënvizoi se "mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm për ndalimin real të luftes dhe humbjet e mëdha njerëzore e materiale" janë pengesat kryesore për paqen, ndërsa sulmet e qëllimshme ruse ndaj infrastrukturës civile përbëjnë një "akt barbar që rëndon mbi popullsinë civile, sidomos tani në prag të dimrit."

Ambasadori Shkurov vë në dukje se "pa pjesëmarrjen e Ukrainës, çdo marrëveshje ndërkombëtare

mbetet vetëm një mundësi e parealizuar për paqe të drejtë", duke kritikuar mungesën e vullnetit të Kremlinit për përfundimin e konfliktit. Ai thekson gjithashtu se Kievi po përpiqet të ruajë "ekuilibrin delikat midis SHBA-së dhe BE-së", në mënyrë që mbështetja e aleatëve të mos kthehet në rivalitet gjeopolitik, por të përkthehet në veprime konkrete për sigurinë dhe rindërtimin e vendit.
I pyetur për takimin Trump–Putin, ai u shpreh se "potenciali për një marrëveshje ekzistonte, por pa pjesëmarrjen dhe dakordësinë e Ukrainës mbi kushtet kryesore, ajo mbeti një mundësi e parealizuar për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme."
Ndërsa për kërkesat e Rusisë për dorëzim territoresh apo heqje dorë nga anëtarësimi në NATO, Shkurov u shpreh prerë: "Integriteti territorial është një parim themelor dhe jo i negociueshëm për Ukrainën. Çdo kërkesë për neutralitet të imponuar nga jashtë bie ndesh me sovranitetin tonë."
Ambasadori Shkurov vlerëson lart mbështetjen e Shqipërisë, të cilën e cilëson "partnere të qëndrueshme të Ukrainës që nga fillimi i agresionit rus", dhe e falënderon për "qëndrimet parimore në NATO dhe OKB, ndihmën humanitare, si dhe nismat për bashkëpunim të sigurisë".
Duke iu drejtuar bashkëkombësve të vet, ai thekson se "guximi dhe qëndrueshmëria e popullit janë garancia e fitores", ndërsa komunitetit ndërkombëtar i bën thirrje "të mos lejojë që mbështetja për Ukrainën të zbehet nga lodhja, sepse çdo vendim i marrë sot ndikon drejtpërdrejt në shpëtimin e jetëve dhe në sigurinë e gjithë Evropës."
"Paqja është qëllimi, por jo paqe me çdo çmim. Ukraina është e gatshme për kompromis vetëm brenda kufijve që nuk cënojnë bazat kushtetuese dhe sigurinë e qytetarëve tanë", thekson ndër të tjera Ambasadori i Ukrainës në Tiranë, SH.T.Z. Volodymyr Shkurov, në intervisten e mëposhtme:

**Intervistoi: Marjana Doda**
**Kryeredaktore| ARGUMENTUM**

**I nderuar z.Ambasador,**
**Është një kënaqësi e veçantë të zhvillojmë këtë intervistë së bashku, veçanërisht pasi vjen pas sfidës shëndetësore që keni përballuar në këtë fillim vjeshte. Më gëzon jashtëzakonisht fakti që shëndeti juaj është përmirësuar plotësisht dhe që sot jeni sërish mes nesh.**
**SHTZ. Volodymyr Shkurov**: Faleminderit për fjalët e ngrohta. Kam kënaqësi të bisedoj me ju. Pas sfidave të fundit me shëndetin, dëshiroj edhe një herë të shpreh mirënjohjen time të sinqertë kolegëve dhe miqve të mi, ndaj të gjithë ata njerëz që mu gjendën pranë në një moment vërtet të vështirë të jetës sime.
Jam thellësisht mirënjohës ndaj mjekëve të departamentit të kardiologjisë në Spitalin Amerikan 3, të cilët, në kuptimin e plotë të fjalës, më shpëtuan jetën; ashtu si edhe jam falënderues i gjithë stafit mjekësor që ishte pranë meje, për profesionalizmin dhe humanizmin e tyre.
Jam i lumtur që jam rikthyer jetës sime të plotë dhe detyrës diplomatike në shërbim të shtetit dhe popullit tonë, të cilët, siç e dini, po përjetojnë tani kohë të vështira në luftën kundër agresorit rus.
**-Znj. Marjana Doda: Shkëlqesia Juaj, ky vit ka qenë një tjetër vit sfidash për Ukrainën dhe popullin ukrainas. A mund të na përmendni cilat janë arritjet, por edhe dështimet gjatë këtij viti, që kanë afruar ose larguar paqen në Ukrainë? Cfarë po ndodh aktualisht në Ukrainë?**
**SHTZ. Volodymyr Shkurov**: Ky vit ka sjellë si arritje të rëndësishme, ashtu edhe sfida të rënda. Ndër arritjet do të përmend forcimin e mbështetjes politike ndërkombëtare të Ukrainës, përparimi në afrimin tonë drejt integrimit evropian, si dhe ndihmën praktike të partnerëve tanë në zmbrapsjen e agresorit, çka u mundëson Forcave tona të Armatosura të mbrojnë pozicionet dhe të zhvillojnë operacione kundërsulmuese atje ku është e arsyeshme. Dua të veçoj posaçërisht guximin e ushtarëve tanë, vetëmohimin e punonjësve tanë të shërbimeve të emergjencës, mjekëve dhe qytetarëve të zakonshëm që, me ndershmëri e ndërgjegje, bëjnë punën e tyre në këto kohë të vështira për Ukrainën. Gjithashtu, mund të theksohet përparim në zhvillimin dhe përsosjen administrativo-juridike të jetës shoqërore në vend, që është thelbësor për sigurimin e rindërtimit të ardhshëm të shtetit. Në veçanti, Komisioni Evropian, në raportet e tij të fundit, konstaton arritje reale të Ukrainës në rrugën drejt anëtarësimit në BE, një fakt i cili, pavarësisht sfidave të rënda të luftës, na ngjall një farë optimizmi.
Ndër dështimet — ose më saktë, sfidat — do të përmendja në radhë të parë mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm që do të siguronte ndalimin real të zjarrit, si dhe humbjet e mëdha

njerëzore dhe materiale; vuajtjet e civilëve si pasojë e sulmeve të qëllimshme me dronë dhe raketa të agresorit ndaj infrastrukturës civile dhe energjetike të qyteteve dhe fshatrave tona, veçanërisht tani, në prag të dimrit.

Gjithashtu, mund të flasim për disa mospërputhje brenda koalicionit ndërkombëtar lidhur me mekanizmat dhe afatet e furnizimit me sisteme kyçe armatimi, gjë që nganjëherë ngadalëson zbatimin efektiv të vendimeve operative nga ana e forcave tona ushtarake.

Thënë ndryshe, Ukraina sot vazhdon të mbrojë shtetin e vet dhe, në të njëjtën kohë, po punon me këmbëngulje në nisma politike e diplomatike për krijimin e kushteve për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.



Ambasadori Ukrainës në Shqipëri, SHTZ. Volodymyr Shkurov
Marjana Doda, Kryeredaktore, Argumentum.al

**-Zoti Ambasador, një nga ngjarjet më të rëndësishme të këtij viti ka qenë takimi Trump-Putin, ku kryesisht u diskutua lufta Ruso-Ukrainase. Samiti përfundoi pa ndonjë marrëveshje konkrete. A mendoni se ky takim humbi mundësinë për të përfunduar luftën, dhe cilat mund të ishin rezultatet e mundshme të një marrëveshjeje?**

Çdo lloj bisede e drejtpërdrejtë midis udhëheqësve të shteteve që janë në luftë ose që ndikojnë në ecurinë e saj ka potencialin të ndryshojë situatën. Megjithatë, rezultati real shpesh varet nga detajet, nga shkalla e transparencës dhe — më e rëndësishmja! — nga gatishmëria e palëve për kompromis. Për momentin, takimi që ju keni përmendur, midis presidentëve D. Trump dhe V. Putin përfundoi pa arritur ndonjë marrëveshje konkrete për ndalimin e zjarrit; dhe si rezultat i saj nuk u hartua asnjë rrugëhartë e përshtatshme me garanci sigurie për Ukrainën. Kjo do të thotë se, teorikisht, potenciali ekzistonte, por zbatimi i tij, pa pjesëmarrjen dhe dakordesinë e Ukrainës mbi kushtet kryesore, mbeti një mundësi e parealizuar për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme të kësaj lufte që Rusia po zhvillon kundër Ukrainës. Në përgjithësi, takime të tilla duhen vlerësuar me kujdes: rezultati i mundshëm mund të parashikonte ose një armëpushim të përkohshëm me garanci sigurie, ose presion mbi Ukrainën për lëshime territorial, dhe kjo e fundit, siç e kuptoni, është e papranueshme për ne. Dhe kohet e fundit, të gjithë patën mundësi të binden se Putini nuk ka vullnet ta përfundojë luftën, pavarësisht deklaratave të herëpashershme të Kremlinit për synime paqësore

**-Si po e menaxhon Ukraina disbalancën midis qëndrimeve të SHBA-së dhe BE-së në lidhje me përpjekjet për përfundimin e konfliktit? Duket se ka një konkurrencë mes dy fuqive për të imponuar kushtet e tyre, duke krijuar një ndarje të mundshme për mënyrën se si të trajtohet ky konflikt që**

**ka arritur në prag të Europës. Si e vlerësoni ndikimin e kësaj situate për strategjinë dhe qëndrimin e Ukrainës?**
Ukraina në këtë fushë po zhvillon një punë delikate diplomatike, pasi është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e partneritetit si me SHBA-të, ashtu edhe me Evropën. Secili partner na siguron mundësi unike: SHBA-ja siguron teknologji mbrojtëse kritike dhe mbështetje të domosdoshme politike, ndërsa Bashkimi Evropian, përveç ndihmës së sigurisë, jep ndihmë ushtarake, mbështetje të gjerë financiare e ekonomike, si dhe asistencë ligjore, si dhe instrumentet e nevojshme për realizimin e planeve tona të integrimit evropian.
Ne synojmë të minimizojmë çdo formë konfrontimi midis këtyre partnerëve tanë të rëndësishëm, duke shpjeguar hapur pozicionet dhe interesat tona, si dhe duke demonstruar se një Ukrainë e fortë, demokratike dhe evropiane – është stabiliteti për të gjithë Europën dhe për aleancën transatlantike.
Strategjia jonë është të diversifikojmë në mënyrë maksimale burimet e ndihmës dhe të formojmë paketa të përbashkëta e të koordinuara masash, në mënyrë që vendimet të merren në interes të sigurisë dhe të rindërtimit të mëtejshëm të Ukrainës, e jo si rezultat i rivalitetit midis aleatëve.
Duke qenë në kushte të ashpra lufte, ne – më shumë se kushdo tjetër – synojmë unitetin dhe mbështetjen në marrjen e çdo vendimi strategjik, pasi çmimi që populli ynë po paguan në këtë luftë – është jeta e njerëzve tanë. Dhe një çmim i tillë nuk mund të barazohet me asgjë.

**– Z. Ambasador, sa efektive ka qenë koalicioni i gatshmëve i vendeve evropiane në mbrojtjen e Ukrainës dhe në nxitjen e paqes? Cilat janë hapat më të rëndësishëm që duhet ndërmarrë tani për të afruar një paqe të ndrueshme në Ukrainë?**
Mbështetja evropiane ka qenë dhe mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme: sanksionet, ndihma financiare, furnizimi me armë, si dhe mbështetja humanitare — të gjitha këto elemente sigurojnë dhe forcojnë rezistencën tonë efektive. Sot, kur armiku po shkatërron në mënyrë masive sistemet energjetike të Ukrainës, na është, në mënyrë jetike e nevojshme, mbështetja për qytetet dhe fshatrat tanë, për të mundësuar gjërat më thelbësore: ujin, ngrohjen dhe energjinë elektrike.
Ndërkohë, sfida mbeten, përkatësisht: nevojitet një koordinim më i qartë, vendimmarrje më të shpejta për përdorimin e instrumenteve ekzistuese (përfshirë këtu edhe një mekanizëm ligjor për mobilizimin e aseteve të bllokuara ruse), si dhe plane të mire përcaktuara dhe afatgjata për sigurimin e procesit të rindërtimit të Ukrainës.
Ndër hapat më të rëndësishëm për momentin janë: furnizimet e qëndrueshme me municione dhe sisteme të mbrojtjes ajrore, garancitë për financim të nevojshme që do të siguruar vitalitetin e shtetit në kushtet e përballjes me agresionin rus, si dhe një politikë e mirë menduar për rikthimin dhe rindërtimin e territoreve pas përfundimit të kësaj lufte.
Nismat që po diskutohen në nivelin e BE-së dhe të G7-s për përdorimin e aseteve të ngrira ruse si burim për rindërtimin e Ukrainës, siç e kuptoni, kërkojnë një zbatim të qartë juridik.

**-I nderuar Ambasador, duke pasur parasysh pasigurinë aktuale në politikën e SHBA-së, veçanërisht në lidhje me armët e përparuara si raketat Tomahawk, dhe vonesat në planet evropiane për të përdorur asetet e ngrira ruse, si po e përshtat Ukraina strategjinë e saj ushtarake dhe diplomatike për të siguruar përpjekjet e vazhdueshme të mbrojtjes?**
Ukraina vazhdon të punojë njëkohësisht në tre drejtime: në nivel operacional — mbështetja dhe modernizimi i kapaciteteve ushtarake përmes platformave ndërkombëtare të disponueshme; në nivel diplomatik — puna aktive me partnerët për përshpejtimin e vendimeve mbi furnizimin me lloje kritike të armëve dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore; dhe në nivel të brendshëm — optimizimi i prodhimit të brendshëm, i logjistikës dhe sigurimi i qëndrueshmërisë tonë ekonomike. Ne përpiqemi të rrisim fleksibilitetin tonë të brendshëm: po zhvillojmë kapacitete prodhuese të brendshme, po shfrytëzojmë më efektivisht burimet e disponueshme dhe po kërkojmë mënyra praktike për të siguruar furnizime të shumanshme. Në të njëjtën kohë, vazhdojmë negociatat për sistemet me teknologji të lartë: vendimet për çështje të caktuara (p.sh. armët me rreze të gjatë veprimi) i marrin partnerët tanë ndërkombëtarë, dhe Ukraina përpiqet t'i adaptojë planet taktike të veta në përputhje me këto vendime. Ngjarjet e fundit tregojnë për një diskutim aktiv brenda Aleancës dhe në SHBA rreth mundësisë së transferimit të mjeteve më të fuqishme me

rreze të gjatë për Ukrainën.
Shpresojmë me forcë që një vendim i tillë të merret, sepse partnerët tanë kanë mjaft fakte për t'u bindur se, pa presion mbi agresorin, është e pamundur ta inkurajosh atë të kërkojë një zgjidhje paqësore të konfliktit.

**-Përballë kërkesave të Rusisë për dorëzimin e territoreve të pushtuara, si rajoni i Donbasit, a është Ukraina e gatshme të shqyrtojë mundësinë e një marrëveshjeje paqeje që përfshin këto territore, apo kjo mbetet një vijë e pakalueshme për shtetin ukrainas?**
Për Ukrainën, integriteti territorial është një parim themelor. Ne nuk e konsiderojmë heqjen dorë nga sovraniteti apo legjitimimin e aneksimeve si një bazë të pranueshme për paqe. Çdo marrëveshje paqësore duhet të mbështetet në të drejtën ndërkombëtare, në respektimin e kufijve ndërkombëtarisht të njohur dhe në garantimin e sigurisë së qytetarëve tanë.
Në të njëjtën kohë, jemi të hapur për bisedime konstruktive në çdo format, me pjesëmarrjen e ndërmjetësve ndërkombëtarë dhe me sigurimin e garancive që do të mundësonin rikthimin e plotë të kontrollit mbi territoret e pushtuara, rivendosjen e të drejtave të njerëzve që jetojnë atje dhe vënien përpara drejtësisë të agresorit.
Ukraina nuk do të shqyrtojë zgjidhje të thjeshta 'paketë', të cilat do të cenonin interesat tona themelore.

**-Rusia ka kërkuar gjithashtu që Ukraina të heqë dorë nga aspiratat për anëtarësim në NATO dhe të shpallë neutralitet. Si do ta ndikonte një vendim i tillë sigurinë dhe strategjinë ushtarake të Ukrainës? A është ky kusht i negociueshëm për Ukrainën?**
Pozicioni përkatës i Ukrainës miratohet nga shoqëria ukrainase dhe nga organet e pushtetit të zgjedhura në mënyrë demokratike. Çdo çështje që lidhet me sigurinë tonë, përfshirë edhe statusin e sigurisë, duhet të zgjidhet vetëm nga vetë Ukraina, pa ndonjë presion të jashtëm.
Vlera historike për ne mbetet e drejta jonë për të zgjedhur në mënyrë të pavarur se në cilat aleanca të anëtarësohemi dhe çfarë garancish të zbatojmë. Prandaj, çdo kërkesë e diktuar nga jashtë që nënkupton neutralitet ose heqje dorë nga aleancat e ardhshme, bie ndesh me parimet e sovranitetit tonë dhe nuk mund të imponohet si kusht për paqe.
Për ne, thelbësore mbeten jo deklaratat të neutralitetit, por garancitë reale të sigurisë, të cilat, në parim, mund të jenë objekt negociatash, por vetëm me pjesëmarrjen e Ukrainës dhe me mekanizma të përshtatshëm ndërkombëtarë të kontrollit.

> **Vlera historike për ne mbetet e drejta jonë për të zgjedhur në mënyrë të pavarur se në cilat aleanca të anëtarësohemi dhe çfarë garancish të zbatojmë. Prandaj, çdo kërkesë e diktuar nga jashtë që nënkupton neutralitet ose heqje dorë nga aleancat e ardhshme, bie ndesh me parimet e sovranitetit tonë dhe nuk mund të imponohet si kusht për paqe.**

**– Pas tre vitesh të luftës dhe mbështetjes ndërkombëtare të shtuar, sa afër është Ukraina të plotësojë kërkesat për anëtarësim në NATO dhe BE? Cilat janë përparësitë dhe pengesat më të mëdha për Ukrainën në këtë rrugë?**
Ukraina ka bërë përparim të dukshëm në përmbushjen e kërkesave teknike dhe ligjore për integrimin evropian: raportet e fundit të Komisionit Evropian vlerësojnë suksesin e arritur në kuadër të klasifikimeve dhe "rrugë-hartave" të reformave.
Megjithatë, anëtarësimi i plotë në NATO dhe BE është një proces i ndërlikuar dhe shumëdimensional, që kërkon kohë, konsensus politik nga vendet anëtare dhe zbatim të suksesshëm të reformave të brendshme. Prioritetet kryesore mbeten reforma e sistemit gjyqësor, lufta efektive kundër korrupsionit, modernizimi i sistemit qeverisës të administratës shtetërore, si dhe garantimi i funksionimit normal të institucioneve demokratike.
Pengesë për këtë mbetet lufta e shkaktuar nga Rusia, e cila konsumon burime të nevojshme, nxit përçarje politike mes vendeve kandidate dhe ndikon në sigurimin e përputhshmërisë me aspektet teknike të përshtatjes ndaj standardeve të Aleancës dhe të BE-së.
Megjithatë, mund të thuhet

me siguri se dinamika e përgjithshme është pozitive dhe se mbështetja e qëndrueshme e partnerëve tanë ndërkombëtarë mbetet një faktor vendimtar.

**-Z. Ambasador, si e vlerësoni mbështetjen e Shqipërisë për Ukrainën gjatë këtyre viteve të fundit, dhe çfarë mund të bëhet më shumë nga Shqipëria për Ukrainën në këtë fazë të luftës?**

Që nga fillimi i agresionit rus, Shqipëria ka qenë dhe mbetet një partnere e qëndrueshme e Ukrainës: kjo përfshin deklaratat politike në mbështetje të sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit tonë, përfshirë edhe rezolutën përkatëse të miratuar nga Parlamenti Shqiptar, ndihmën humanitare të ofruar nga Shqipëria për Ukrainën, si dhe hapat praktikë të ndërmarrë në kuadër të NATO-s dhe nismave të ndryshme rajonale.

Marrëveshja e fundit për bashkëpunim në fushën e sigurisë ka konfirmuar gatishmërinë e Tiranës për mbështetje afatgjatë. Për forcimin e mëtejshëm të kësaj ndihme, Shqipëria mund të vazhdojë të kontribuojë në konsolidimin e qëndrimeve, për shembull në kuadër të NATO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare; të mbështesë paketat përkatëse të sanksioneve dhe nismat ndërkombëtare për përdorimin në dobi të Ukrainës të aseteve të ngrira ruse; në kthimin e fëmijëve ukrainas të rrëmbyer dhe të dërguar në Rusi; të marrë pjesë në projekte arsimore dhe prodhuese me Ukrainën; si dhe të forcojë koordinimin rajonal për furnizimet dhe rindërtimin e Ukrainës.

> **Ne jemi mirënjohës ndaj çdo partneri që gjatë gjithë kësaj periudhe të vështirë ka qëndruar përkrah Ukrainës. Megjithatë, duhet ta kuptojmë se fjala "mbështetje" duhet të shndërrohet në veprime konkrete dhe të shpejta, për të garantuar mbrojtjen efektive të njerëzve, të objekteve të infrastrukturës kritike dhe për përgatitjen e duhur të procesit të rindërtimit të vendit.**

**-Zoti Ambasador, nisur nga skenarët e ndryshëm për përfundimin e luftës dhe kërkesat që Rusia ka shprehur, si shtetas i Ukrainës dhe pastaj si diplomat, në këto kushte, çfarë do të mund të sakrifikonte Ukraina për të rikthyer paqen?**

Si diplomat, do të doja të theksoja se: paqja është qëllimi, por jo paqe me çdo çmim. Ukraina është e gatshme për kompromis brenda atyre kufijve që nuk vënë në dyshim bazat tona kushtetuese dhe sigurinë e qytetarëve tanë.

Si qytetar, do të doja të theksoja se e kuptoj dhe e ndjej dhimbjen e humbjeve dhe, ashtu si çdo ukrainas, dëshiroj përfundimin e luftës. Megjithatë, besoj se asnjë sakrificë nuk mund të nënkuptojë heqjen dorë nga të drejtat themelore të popullit tonë dhe nga integriteti territorial i Atdheut.

Prandaj, kompromiset e mundshme mund të lidhen me garancitë e përkohshme të sigurisë, me regjimet e kontrollit ose me mekanizmat ekonomikë të kompensimit; por ato nuk duhet të përfshijnë njohjen e aneksimeve apo heqjen dorë nga të drejtat tona themelore sovrane.

**-Duke përmbyllur një vit të gjatë dhe të vështirë lufte në Ukrainë, a keni Ju një mesazh që dëshironi t'ia përcillni komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëkombasve tuaj, në një kohë kur shpresa për paqe mbetet ende sfida më e madhe?**

Ne jemi mirënjohës ndaj çdo partneri që gjatë gjithë kësaj periudhe të vështirë ka qëndruar përkrah Ukrainës. Megjithatë, duhet ta kuptojmë se fjala "mbështetje" duhet të shndërrohet në veprime konkrete dhe të shpejta, për të garantuar mbrojtjen efektive të njerëzve, të objekteve të infrastrukturës kritike dhe për përgatitjen e duhur të procesit të rindërtimit të vendit.

Bashkëkombësve të mi dua t'u them: guximi, qëndrueshmëria dhe trimëria juaj mbeten themeli i vitalitetit të Ukrainës — garancia e fitores sonë. Të gjithë ne jemi një borxh të pashlyeshëm ndaj mbrojtësve tanë. Populli i Ukrainës duhet të ruajë unitetin, të vazhdojë zbatimin e reformave edhe në kohë lufte dhe, sa të jetë e mundur, të fillojë rindërtimin e vendit që sot.

Komunitetit ndërkombëtar do të doja t'i bëja thirrje, të mos lejojë që mbështetja për Ukrainën të zbehet nga lodhja. Sido që të jetë, por edhe sot vendimet që merren në zyrat e partnerëve tanë ndërkombëtarë kanë rëndësi vendimtare për shpëtimin e jetëve të mijëra njerëzve dhe për sigurinë e gjithë Evropës.

# Armëpushim tregtar! Raporte progresi apo Regresi?

REAL POLITIK NR. 116 | 28 TETOR – 25 NENTOR 2025 | EKSKLUZIVISHT PER FOR ARGUMENTUM

**Komente " flash" mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur**

DR. JORGJI KOTE
*MJESHTËR I MADH NË DIPLOMACI*



## 1.

***Armëpushim tregtar!*** Kështu u konsiderua takimi i shumëpritur më 30 tetor në Busan të Koresë së Jugut midis Presidentit amerikan Trump dhe homologut të tij kinez Xi Jinping. Ai erdhi pas kërcënimeve të forta mes tyre, duke rrezikuar një luftë botërore me pasoja të paparashikueshme. Politikat e reja ekonomike të Presidentit Trump dhe tarifat tejet të larta të SHBA-ve ndaj Kinës, BE-së dhe vendeve të tjera mund ta minonin tregtinë botërore, e cila edhe kështu është tejet e mbingarkuar me tensione dhe konflikte. Por, diplomacia dhe qëndrimet e matura e të arësyeshme të këtyre dy vendeve bënë që kjo përplasje të shmangej qoftë edhe përkohësisht. U arrit më në fund paqja mes këtyre dy vendeve. Më vonë, ajo u shpall edhe për vendet e BE-së. Edhe pse me një afat një vjeçar por me mundësi ripërtëritjeje, ajo lehtësoi ndjeshëm edhe eksportet kineze të metaleve të rralla, ku ajo dikton tregjet, të cilat janë përcaktuese për ekonomitë, sigurinë, teknologjitë dhe mbrojtjet e të gjitha vendeve perendimore.
Gjithsesi, kujdes, se këtu në fakt nuk bëhet fjalë për një paqe të vërtetë dhe afat-gjatë ekonomike por thjesht për një « armëpushimtregtar » të përkohshëm por të dobishëm. Ndaj diplomacitë në të gjitha vendet vazhdojnë me ngulm të punojnë në kërkim të një paqeje të vërtetë dhe të qëndrueshme tarifore.

## 2.

***Raporte progresi apo regresi?*** Kjo është pyetja që lind pasi njihesh me të ashtuquajurat Progres Raporte që Komisioni Europian publikoi më 4 nëntor. Ka vite që në prag të fund vitit, ai publikon dokumenta të tilla të cilat rreket të tregojnë konkretisht përparimin e secilit vend kandidat në Ballkanin Perendimor në të gjitha fushat. Është një vlerësim i bërë me lupë nga trupa e madhe e ekspertëve të Komisionit Europian.




Mirëpo problemi është se ka vite që këto raporte me treguesit e tyre sintetikë, në fakt më shumë flasin dhe shkruajnë për regres, se sa për progres për të gjitha vendet e rajonit tonë, pa përjashtim. Lexojini dhe do të shihni se atje ka shumë më tepër vërejtje, kritika, mungesa dhe mangësi se sa arritje. Edhe vendi ynë, pa mohuar arritjet, duket se vazhdon të çalojë në shumë sektorë jetikë, dhe sidomos për luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, një seri qortimesh për fushat zgjedhore me parregullsi të shtuara, etj.

Ndaj, me të drejtë është sugjeruar që të mos quhen më raporte progresi, por të gjindet një emër më i përshtshëm për këto dokumenta bazë. Ca më tepër se vendet anëtare dhe Parlamenti Europian pritet të shtojnë kritika dhe vërejtje edhe më politike kur t'i shqyrtojnë ato së shpejti.



## 3.

### *" Malorja " e negociatave 2027!*

Më 17 Nëntor në Bruksel, bashkë me Grup Kapitullin e Pestë, u çelën të 33 kapitujt e negociatave tona të anëtarësimit në BE. Moment i rëndësishëm që vlen për t'u përshëndetur. Mirëpo kjo realisht do të thotë se "viti i mjaltit me BE-në " mbaroi, tani kemi 2 vite plot punë dhe sfida. Sepse, nëse deri tani ishim në "fushore" në 24 muajt e mbetur na duhet të ecim në një " malore" me plot kthesa të forta.

Lajmi i mirë është se në këtë rrugtim kemi krijuar disa avantazhe të rëndësishme. Brenda vendit kemi mbështetjen më të madhe publike në rajon për anëtarësimin në BE; kemi shumë përvojë në 11 vitet pas fitimit të statusit kandidat; kemi një ekip negociatorësh me përvojë, të aftë dhe të kualifikuar, kemi një shërbim diplomatik në lartësinë e detyrës, sidomos Përfaqësinë tonë pranë BE-së në Bruksel; shumë i rëndësishëm është kontributi i Kuvendit, i vlerësuar për punën e bërë për përafrimin e legjislacionit tonë me të BE-së dhe mbikqyrjen e gjithë këtij procesi. Jashtë vendit, veç faktorit të favorshëm gjeopolitik, gëzojmë një imazh më pozitiv falë disa hapave të vlerësuar në fushën diplomatike, samiteve europiane në Tiranë, etj. Po ashtu, në parim gëzojmë mbështetjen politike, ekonomike dhe financiare të gjitha vendeve anëtare të BE-së, të Komisionit dhe Parlamentit Europian. Në vijim, ndryshe nga më parë, metodologjia e re e Zgjerimit Europian na lejon të përfundojmë njëherësh disa apo dhe të gjithë grup kapitujt, çka ndikon pozitivisht në përshpejtimin e procesit.

Ndërkaq, kërkohet kujdes në eliminimin e minuseve, deficiteve dhe problematikave të njohura shqetësuese; mbasi nëse nuk zgjidhen ose shmangen, mund të zvogëlojnë dhe zhvleftësojnë arritjet dhe avantazhet e lartpërmendura. Ato i gjen në dokumentat e BE-së dhe kornizat negociuese; i përmendi në prani të Kryeministrit Rama në Bruksel më 4 dhe më 17 Nëntor edhe Komisionerja Marta Kos: reforma zgjedhore, sidomos pas publikimit të raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR mbi zgjedhjet parlamentare të 11 majit që janë përfshirë copy&paste në të gjitha raportet e BE-së dhe të organizatave ndërkombëtare, dialogu me opozitën, sjellja e pushtetit ndaj medias nga qeveria dhe aktorë të tjerë, pavarësia e gjyqësorit, parimi i ndarjes së pushteteve, autonomia e pushtetit vendor, transparenca me fondet publike, etj. Duke i zbërthyer këto komponentë në të gjitha elementët e tyre, shihet qartë " Mali" me probleme dhe " malorja" që do të na duhet të ngjitim eri në vitin 2027 me negociatat në fjalë.

## 4.

### *Paqe, jo pushtim dhe kapitullim!*

Këto ditët e fundit kanë vazhduar në Gjenevë, Uashington, Kiev dhe në Europë demarshet diplomatike në të gjitha nivelet në përpjekje për të hartuar një plan faktikisht krejt të ndryshëm nga ai i propozuar nga Uashingtoni më 20 nëntor. Europa reagoi sërish me të drejtë bashkë me Kievin dhe bëri gjithçka të mundur për një marrëveshje të re, të ndryshme, për armëpushimin dhe pastaj për një paqe të vërtetë dhe të drejtë. Paqe mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare, jo nga pozita e më të fortit, jo për ndryshimin e kufijve me armë, për një Ukrainë sovrane në territoret e veta, me ushtrinë e saj të fuqishme, me vullnetin e saj për anëtarësim në BE dhe në NATO dhe me mbështetjen e gjithanshme të aleatëve perendimorë. Shkurt paqe, jo pushtim, poshtërim dhe kapitullim i Ukrainës dhe bashkë me të edhe i Europës. Një paqe ku agresori të dallohet nga viktima, madje ai të ndëshkohet e jo të përkëdhelet.

Gjithsesi, nisur nga synimet gjeostrategjike ruse, ambicien e saj për të ringritur perandorinë sovjetike, kjo paqe do të jetë shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur pa luftën e Ukrainës deri në fitore. Gjithsesi, ajo mbetet alternativa me mirë për këtë paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme.

# Rama dhe Kos pas Samitit të Planit të Rritjes: Integrimi po përshpejtohet, debati politik fokus te drejtësia dhe rasti Balluku




Në përfundim të Samitit të Planit të Rritjes së BE-së "Our Pathway to the EU", kryeministri Edi Rama dhe Komisionerja për Zgjerimin Marta Kos zhvilluan një konferencë të përbashkët për shtyp, ku theksuan përparimin e Shqipërisë drejt integrimit dhe rëndësinë e zbatimit të reformave të mbetura. Rama deklaroi se samiti prodhoi hapa konkret që afrojnë rajonin me tregun e përbashkët europian, duke përfshirë marrëveshjen e re të roaming-ut me BE-në, zgjerimin e identitetit dixhital që pritet të zbatohet në fillim të vitit 2025, lehtësimin e tregtisë kufitare, përmirësimin e korridoreve europiane dhe nxitjen e bashkëpunimit në turizëm e arsimin e lartë.

> "Pavarësia e gjyqësorit nuk është as slogan, as manovër politike dhe as eksperiment i përkohshëm, por është një shkëputje historike nga e kaluara, e realizuar vetëm në vitet e fundit. Kjo pavarësi ka sjellë një risi absolute në jetën institucionale të Shqipërisë dhe zhvillime të padiskutueshme pozitive, duke filluar nga një fakt i pamohueshëm varrosja e kulturës 100 e kusur vjeçare të pandëshkueshmërisë".

Komisionerja Kos vlerësoi angazhimin e Shqipërisë dhe të rajonit, duke e cilësuar progresin në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit si "të paprecedentë" në dy vitet e fundit. Ajo theksoi se BE-ja synon integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në sa më shumë politika europiane përpara anëtarësimit të plotë dhe kërkoi përshpejtimin e reformave përpara afatit të qershorit 2025. Sa i përket zgjedhjeve të 11 majit, Kos i cilësoi ato "të lira dhe të ndershme", duke shtuar se sugjerimet për përmirësim janë pjesë e procesit normal demokratik.

Pyetjet politike u përqendruan te çështja e pezullimit nga detyra të zv.kryeministres Belinda Balluku. Rama e cilësoi vendimin e gjykatës si "unik në historinë e Europës" dhe si ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë e ekze-

kutivit, por u shpreh se qeveria do ta respektojë plotësisht vendimin, duke ia lënë Gjykatës Kushtetuese fjalën e fundit. Ai theksoi se qeveria nuk do të ketë zëvendëskryeministër deri në vendimin e Kushtetueses, ndërsa mbrojti parimin e pavarësisë së drejtësisë dhe nevojën për të shmangur përplasjet politike me institucionet e reja të sistemit.

"Mbrojtja e pavarësisë së re dhe jo të përkohshme të sistemit të drejtësisë është prioriteti absolut edhe përballë situatave kaq flagrante sa kjo situatë, për të cilën po drejtësia duhet të gjejë përgjigjen kushtetuese", tha Rama.

"Këta jemi ne, ky jam unë dhe kështu do të jetë deri në fund kur unë të kem privilegjin që të udhëheq Shqipërinë për ta bërë anëtare të Bashkimit Europian", deklaroi Rama.

Kreu i qeverisë u shpreh se "nëse sot Shqipëria i ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave për anëtarësim ndër disa arsye themelore është edhe fakti se Shqipëria po e lufton seriozisht korrupsionin dhe krimin e organizuar".

"Pa diskutim që sot edhe fakti që mund të bëhen pyetje me këtë përmbajtje lidhet me një epokë të re ku kemi hyrë. Në këtë epokë të re Shqipërinë e ka futur kjo shumicë qeverisëse, me mua në krye", u shpreh Rama, duke iu referuar pyetjes së gazetares për Ballukun.

Më tej, Rama tha se "së pari, pavarësia e gjyqësorit nuk është as slogan, as manovër politike dhe as eksperiment i përkohshëm, por është një shkëputje historike nga e kaluara, e realizuar vetëm në vitet e fundit. Kjo pavarësi ka sjellë një risi absolute në jetën institucionale të Shqipërisë dhe zhvillime të padiskutueshme pozitive, duke filluar nga një fakt i pamohueshëm varrosja e kulturës 100 e kusur vjeçare të pandëshkueshmërisë".

Por, vijoi Kryeministri, ama ka shfaqur edhe dobësitë e natyrshme të një pushteti krejt të ri fëminor për nga mosha, si dhe reflekse të vjetra antidemokratike.

"Së dyti, dua të theksoj se pavarësisht dhe përtej kostove të larta që kanë për vendin dhe jo thjesht për ne këto reflekse të vjetra antidemokratike të trupave të reja speciale, për ne dhe për mua personalisht mbrojtja e pavarësisë dhe ruajtja e pavarësisë së sistemit të drejtësisë janë parakushte për çdo qëndrim nga ana jonë, sepse siç thotë edhe një fjalë e mençur që mua më pëlqen shumë: "Kurrë nuk duhet hedhur fëmija bashkë me ujin e pistë"", theksoi Rama.



EDI RAMA

*Mbrojtja e pavarësisë dhe ruajtja e pavarësisë së sistemit të drejtësisë janë parakushte për çdo qëndrim nga ana jonë, sepse siç thotë edhe një fjalë e mençur që mua më pëlqen shumë: "Kurrë nuk duhet hedhur fëmija bashkë me ujin e pistë".*

Kryeministri Rama tha se, "pezullimi nga detyra i një ministri, në këtë rast edhe zv.kryeministres drejtpërdrejt përgjegjëse për drejtimin e qeverisë në mungesë të Kryeministrit është një tjetër shfaqje e pikërisht atyre dobësive që përmenda më lart dhe një pushteti krejt të ri dhe e refekseve antidemokratike që përmenda po ashtu më lart".

"Ky është një rast unikal në historinë e Europës dhe po ashtu në historinë e trupave speciale të drejtësisë që janë krijuar në proceset e integrimit europian të vendeve të ish-Lindjes komuniste, ku s'ka ndodhur kurrë që një prokuror dhe një gjykatës të mblidhen kokë më kokë dhe të pezullojnë nga detyra një anëtar qeverie. Por, nëse një prokuror special dhe një gjykatës special i Shkallës së Parë të Speciales këtu në Shqipëri kanë vendosur të pezullojnë një ministër, cenimi i drejtpërdrejtë i pavarësisë dhe funksionimit të një pushtetit tjetër të pavarur siç është ekzekutivi, duke marrë kompetencat e kryeministrit, Presidentit dhe të Parlamentit – prej nga buron mandati i qeverisë dhe çdo ministri – zgjedhja jonë në raport me këtë fakt është strategjikja, si gjithmonë për ta ruajtur dhe mbështetur pavarësinë e gjyqësorit si parakusht edhe në këtë rast ekstrem", nënvizoi Rama.

E thënë drejtpërdrejt, shtoi Kryeministri, "ne nuk mund t'i përgjigjemi një arbitrariteti të këtyre përmasave me asnjë lloj arbitrariteti dhe as nuk të angazhohemi, larg qoftë, në një betejë politike, retorike me drejtësinë".

"Por, ne do të vazhdojmë me durimin tonë strategjik", tha kryeministri Rama.

# 30-vjetori i Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit që i dha fund luftës në Bosnjë e Hercegovinë




Më 21 Nëntor shënohet 30-vjetori i Nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes së Daytonit, një moment kyç në historinë e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ky përvjetor na kujton jo vetëm përfundimin e luftës, por edhe sfidat e vazhdueshme që vazhdon t`ë përballet shoqëria dhe sistemi politik i vendit.

Marrëveshja e dha fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, e cila zgjati nga viti 1992 deri në vitin 1995, duke përfunduar zyrtarisht më 14 dhjetor 1995 me nënshkrimin e saj në Paris. Nënshkruesit ishin Alija Izetbegoviç, Slobodan Milloseviç dhe Franjo Tuđman. Marrëveshja u ndërmjetësua nga diplomati amerikan Richard Holbrooke dhe Gjenerali Wesley Clark, dhe u nënshkrua zyrtarisht në Pallatin Élysée.

Marrëveshja e Daytonit e përcaktoi Bosnjën dhe Hercegovinën si një shtet të tre popujve përbërës dhe krijoi dy entitete: Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikën Srpska. Këto entitete u bënë njësitë kryesore administrative të vendit.

Marrëveshja përfshinte 12 anekse që rregullonin aspektet politike, ushtarake dhe ligjore të paqes. Arritja e saj më e madhe konsiderohet ndalimi i luftës dhe vendosja e paqes.

> *Marrëveshja e dha fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, e cila zgjati nga viti 1992 deri në vitin 1995, duke përfunduar zyrtarisht më 14 dhjetor 1995 me nënshkrimin e saj në Paris.*

Megjithatë, Marrëveshja e Daytonit la pas një sistem politik kompleks dhe shpesh joefikas, i cili ka qenë objekt kritikash dhe debatash për tre dekadat e fundit. Shumë mendojnë se, megjithëse marrëveshja ndaloi luftën, ajo nuk krijoi një shtet të qëndrueshëm, duke lënë vendin të ndarë në baza etnike.

Pavarësisht këtyre sfidave, marrëveshja hapi rrugën për integrim në institucionet ndërkombëtare. Bashkimi Evropian dhe NATO kanë qenë partnerë të rëndësishëm në stabilizimin e vendit dhe mbështetjen e reformave.

Ky përvjetor është një mundësi për të kujtuar viktimat e luftës dhe rëndësinë e paqes. Marrëveshja e Daytonit mbetet simbol i përfundimit të luftës, por gjithashtu një kujtesë për nevojën e reformave të vazhdueshme politike dhe shoqërore.

# Diplomati amerikan Christopher Hill dëshmon në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë

Diplomati amerikan Christopher Hill ka dëshmuar sot në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, në procesin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Hill, i identifikuar me kodin 1DW-008, është dëshmitari i pestë i thirrur nga mbrojtja e Thaçit, e përfaqësuar nga avokati Luka Mishetiq. Para dëshmisë së tij, gjykata pranoi një video-material si provë, kërkesë e bërë nga mbrojtja dhe e pa kundërshtuar nga Prokuroria.

Sipas vendimit të trupit gjykues, dëshmia e Hill do të kufizohet në tema të caktuara, ndërsa ai ka të drejtë të mos përgjigjet në pyetje që përfshijnë informacione konfidenciale. Në seancë ishte e pranishme edhe Terra Gerhersanem, zëvendëskëshilltare ligjore e Ambasadës së SHBA-së në Hagë.

Christopher Hill gjatë dëshmisë së tij në Hagë tha se në çështjen e Kosovës ishte angazhuar nga SHBA-të në maj të vitit 1998 nga Madeleine Albright, të cilës i raportonte. Ai e kuptonte rolin e tij si diplomat që duhej të ofronte mbështetje ose zgjidhje politike për të ndalur dhunën në Kosovë.

Hill tregoi se me kolegët e Departamentit të Shtetit kishin punuar për një plan autonomie që do t'i kthente Kosovës vetëqeverisjen.

Dëshmia e tij u dha në përgjigje të pyetjeve të mbrojtjes së Hashim Thaçit, të përfaqësuar nga avokati Luka Mishetiq.



Hill tha se si diplomat në Maqedoni dhe Shqipëri, Kosova ishte një temë e madhe, por jo e vetmja në Ballkan, pasi kishte edhe luftëra në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci.

Ai theksoi se deri në maj 1998 nuk e kishte vizituar Kosovën dhe se në bisedimet e Dejtonit fokusi ishte përfundimi i luftës në Bosnjë, por Kosova përmendej nga amerikanë me prejardhje kosovare që kërkonin zgjidhje.

Hill shtoi se kishte biseduar për Kosovën edhe me Sllobodan Millosheviqin, duke theksuar se e dinin që Kosova do të ishte çështja tjetër pas Bosnjës.

Tutje në pyetjen e Mishetiqit se në palën kosovare a keni gjetur ndonjë emër që mund të fliste me autoritet në emër të shqiptarëve të Kosovës, Hill e përshkroi situatën në Kosovë si shumë sfiduese, duke theksuar vështirësinë për të gjetur bashkëbisedues me autoritet politik.

"Ka qenë një sfidë e madhe, në disa momente ishte ndërmarrje e vështirë të gjendeshin njerëz që flisnin me autoritet. Çdokush kishte një mendim lidhur me të, por problemi ishte të gjendej dikush që kishte autoritet. Një prej personave të tillë ishte kreu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili kishte pozitë udhëheqëse në Kosovë," tha Hill.

Kurse në pyetjen e avokatit Mishetiq se kush është takuar me UÇK-në për herë të parë në emër të shteteve të Bashkuara të Amerikës ai tha se me UÇK ishte pamundësia për të zgjedhur një lider udhëheqjeje. Për të gjetur njerëz që mund të flisnin me autoritet.

"Problemi i madh, natyrisht, ishte paaftësia dhe pamundësia për të gjetur një udhëheqje aty, për të gjetur njerëz që flisnin me autoritet," tha Hill, duke shtuar se kjo e bënte të vështirë çdo komunikim zyrtar me përfaqësues të UÇK-së.

Diplomati amerikan, Christopher Hill, i pyetur nga mbrojtja e Hashim Thaçit nëse ambasadori Robert Gelbard i ishte referuar UÇK -së si organizatë "terroriste", ka thënë "po".

"Pati shumë kritika për deklaratën e Gelbard se UÇK-ja ishte organizatë terroriste, dhe kishte fjalë se kjo e kishte shpejtuar këtë ngjarje, pra sulmin në familjen Jashari. Gelbard sikurse kishte dhënë dritën jeshile që kjo të ndodhte. Besoj se nuk ka provë për një gjë të tillë, por ajo është diskutuar, nëse i dërguari amerikan e quan UÇK-në terroriste, jep sinjal serbëve të lëvizin kundër tyre", ka thënë Hill.

Hill ka shpjeguar se Gelbard ishte bazuar në përvojën e tij në Amer-

ikën Latine kur e kishte cilësuar të tillë UÇK-në.

Sipas Hill, Gelbard ishte takuar me disa shqiptarë të Kosovës në Zvicër, të cilët pretendonin se ishin udhëheqës të UÇK-së, por ai vetë nuk besonte se ata ishin përfaqësues të vërtetë të saj. "Nuk mendoj që kjo ishte e vërtetë dhe nuk ka pasur ndonjë provë që ata ishin në fakt udhëheqës të UÇK-së," deklaroi ai. Hill shtoi se nuk i kujtohej saktësisht kush ishin ata persona, por se ishin bërë përpjekje për të zbuluar kush e drejtonte realisht UÇK-në.

Ai tha se njerëzit me të cilët ishte takuar Gelbard kishin simpati të madhe për UÇK-në, duke e parë atë si një lëvizje që përshpejtonte procesin drejt pavarësisë.

Në vijim, Hill shtoi se gjatë verës së vitit 1998 ishin bërë përpjekje për të identifikuar një zyrtar të UÇK-së apo grup zyrtarësh me të cilët mund të flisnim lidhur me UÇK-në, por pa sukses. Ai tha se në Tiranë ishte takuar me një person që u ishte përshkruar si udhëheqës i UÇK-së, por që, sipas tij, nuk kishte autoritetin e duhur për të folur në emër të UÇK-së.

Në vazhdim të dëshmisë, Hill tha se nuk besonte se ekzistonte një Shtab i Përgjithshëm përgjegjës për UÇK-në. Ai e përshkroi këtë si përpjekje për të treguar se ishin një ushtri e strukturuar me hierarki tradicionale.

"Jo, nuk e besoja këtë gjë. Mendoj se ishte më shumë përpjekje për të treguar se ishin një ushtri me hierarki vertikale, një përpjekje për të na bindur se kishin struktura normale politike e ushtarake," u shpreh Hill.

Ai shtoi se disa prej personave me të cilët ishte takuar përpiqeshin të paraqiteshin më të rëndësishëm se sa ishin në realitet. "Isha i dekurajuar, u thashë disa personave se kam frikë që po kërkojmë diçka që në fakt nuk ekziston," tha Hill.

Duke folur për negociatat e paqes, Hill përmendi se në verën e vitit 1998, Ibrahim Rugova nuk hezitonte të jepte emra nga LDK-ja si pjesë të ekipit negociues, por nuk kishte shumë vullnet për të përfshirë persona jashtë partisë.

Ish-diplomati amerikan Christopher Hill, ka folur edhe për kontaktet me persona nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke thënë se qëllimi i tyre ishte realizimi i pavarësisë së Kosovës.

"Ata, domethënë personat me të cilët kemi biseduar, kishin pikëpamjen se nuk mund të negociohej me serbët dhe se ajo çfarë dëshironin të arrinin ishte pavarësia, duke kërkuar që ne t'i ndihmonim për ta siguruar këtë," tha Hill.

Ai shtoi se UÇK-ja kishte interesim për bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Ata ishin të interesuar që të punonin me SHBA-të sepse mendonin që SHBA-të ishin në pozitë për të realizuar objektivat e tyre, që ishte pavarësia afatmesme për Kosovën," theksoi ai.

Sipas Hill, UÇK-ja nuk kishte interes të bashkëpunonte me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

"Në vend që vetë Rugova të ishte zëri i shqiptarëve të Kosovës, ata vetë donin të ishin zëri i shqiptarëve të Kosovës," tha ai, duke shtuar se ishte e vështirë që këtë rol ta merrnin persona që nuk njiheshin. Christopher Hill foli gjithashtu për një takim me Rexhep Selimin në fshatin Likoc, ku kishte shkuar së bashku me Fehmi Agani nga LDK-ja dhe gazetarët Veton Surroi e Blerim Shala. Në takim, sipas Hill, ishin edhe asistentja e tij dhe zëdhënësi për shtyp i Ambasadës së SHBA-së në Shkup.

Ai tha se qëllimi i takimit ishte të kuptonin më mirë se kush e udhëhiqte UÇK-në dhe si mund të përfshihej në një proces politik. "Mendova se kjo ishte urgjente sepse kishim një draft-autonomie dhe nuk po arrinim ta negocionim, pasi nuk kishte përfaqësues të përfshirë," tha Hill.

Hill tregoi se takimi ishte zhvilluar në Likoc dhe më pas udhëtimi kishte vazhduar drejt Shtimes, ku automjeti i tyre ishte goditur me plumba. Sipas tij, Fehmi Agani kishte thënë se mund të bëhej fjalë për një provokim nga serbët.

Në takim, sipas Hill, ishte edhe Mehmet Hajrizi, ndërsa UÇK-së i ishte bërë kërkesa që të rikonstrukturohej dhe të caktohej një "kryeministër i ri".

Për Rexhep Selimin, Hill tha se fillimisht kishte menduar se ai ishte personi që merrte vendime në emër të UÇK-së, por ishte zhgënjyer kur Selimi i kishte thënë se duhej të priste. "Mendova se ai do merrte vendime. U acarova kur më tha se nuk ishte ai që vendoste dhe se mbase javën tjetër do merrej vendimi," u shpreh Hill.

Para këtij takimi, ai tha se kishte pasur edhe një takim në Junik me një person të UÇK-së që kishte mjekër dhe veshje kamuflazhi, por që sipas Hill nuk ishte udhëheqësi i saj.

Ish-diplomati amerikan, Christopher Hill, e ka përfunduar për sot dëshminë në Gjykatën Speciale. Ai do ta vazhdojë dëshminë nesër, nga ora 09:00."

Mbrojtja e Thaçit ka filluar paraqitjen e provave më 15 shtator 2025, me dëshminë e ish-ndihmësit të sekretarit amerikan të shtetit, James Rubin.

# Papa Leo: Takim me Islamin në Turqi e Liban

Gati shtatë muaj pas zgjedhjes Papë Leo XIV ndërmerr udhëtimin e tij të parë jashtë vendit. Ky udhëtim nga 27 deri më 30 nëntor ka stacion Turqinë dhe në përfundim deri më 2 dhjetor Libanin.
Kreu i Kishës Katolike me prejardhje nga SHBA-ja me këtë vazhdon angazhimin ndërkombëtar të paraardhësit të tij. Sot programi i udhëtimeve është pjesë e vetëkuptueshme e ushtrimit të pontifikatit dhe "as që mund të mendohet pa të", thotë historiani i kishës nga Augsburgu dhe ekspert i papës Jörg Ernesti në bisedë për DW.
Pritet me interes se çfarë theksi do të vendosë Leo në udhëtimin e tij të parë dhe se si ai eventualisht do të bëjë dallimin nga paraardhësit e tij. Në Turqi kreu i kishës katolike do të vizitojë kryeqytetin Ankara dhe Stambollin. Ai do të udhëtojë gjithashtu edhe në Iznik rreth 100 km në juglindje, ku 1700 vjet më parë u mblodh këshilli i parë mbarëbotëror i të gjitha kishave.
Në Liban janë në program vizita në Bejrut dhe disa vende pelegrinazhi në veri të vendit. Papa Leo në fund të udhëtimit të tij do të do mbajë një lutje në heshtje në portin e Bejrutit, pikërisht në vendin ku verën e vitit 2020 ndodhi një shpërthim i tmerrshëm me pestidice dhe lëndë plasëse që shkatërroi një lagje të tërë, rreth 200 vetë humbën jetën dhe i gjithë vendi u trondit nga kjo fatkeqësi.

### Në Turqi dhe në Liban dikur jetonin shumë të krishterë

Të dy vendet i bashkon një gjë e veçantë: Përpara njëqind vjetësh në të dyja këto vende të krishterët përbënin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Në Turqi rreth një e treta e banorëve i përkiste një kishe, ndërsa në Liban më shumë se gjysma e popullsisë. Sot në Turqi më



pak një përqind e njerëzve i përkasin besimit kristian, ndërsa në Liban 30 përqind.
Turqia, duke përjashtuar Italinë, është në mbarë botën vendi i parë që ka pasur mysafir pesë papë. Kjo ka të bëjë edhe me faktin, se në pjesën aziatike të Turqisë ka tradita të rëndësishme të historisë së hershme të krishtërimit dhe ndodhen gjithashtu disa nga komunat e para kristiane.
Në Stamboll, dikur Konstandinopoja, edhe sot e kësaj dite kreu i ortodoksisë ka selinë e tij, që aktualisht e mban patriarku greko-ortodoks Bartolomeusi 85 vjeçar. Kisha e tij prej dekadash vuan prej kufizimeve të vendosura nga shteti turk.
Leo shkon – po ashtu si edhe paradhësit e tij Papa Gjon Pali i II (1979), Benedikti (2006) dhe Francesku (2014) – me vetëdije të plotë në fund të nëntorit në Stamboll. Më 30 nëntor është festa e Apostullit Andrea, që për ortodoksinë është po aq i rëndësishëm sa Apostulli Pjetër për të krishterët perëndimorë.

### "Kufizim i lirisë fetare"

Në Turqi sipas vlerësimit të historianit të kishës Ernesti "ka kufizime të lirisë së besimit". Kjo prek në radhë të parë kishën greko-ortodokse, që qysh prej dëbimit të grekëve nga Konstandinopoja dhe Azia e Vogël përpara 100 vjetësh është "asgjësuar dukshëm". Patriarku Ekumenik është i kufizuar në veprimtarinë e tij.
Që prej më shumë se 50 vjetësh pas një dekreti shtetëror është mbyllur seminari i priftërinjve ortodoksë në ishullin Chalki në Detin Marmara pranë Stambollit. Edhe kisha katolike, sipas Ernestit, nuk mund të veprojë e lirë.
Vizita pritet me interes, sepse kjo është vizita e parë e papës në një vend tipik dhe të dominuar mysliman. "Shumë njerëz në botën islamike, pikërisht në Turqi, ndihen të nderuar, që udhëtimi i parë i papës jashtë vendit u dedikohet vendit të tyre", thotë jezuiti Felix Körner për DW.

### Libani vendi me shumë religjone

Edhe Libani është një etapë e rëndësishme e këtij udhëtimi papal. Tradicionalisht ky vend karakterizohet nga të jetuarit pranë njeri – tjetri të shumë besimeve fetare. Në Liban nuk ka një religjon shtetëror. Sot më shumë se 60 përqind e libanezëve janë myslimanë suni dhe shiitë, rreth 30 përqind të krishterë të kishave të ndryshme. Krahas tyre ka dhe druzë e alevitë. Hezbollahu shiit i mbështetur nga Irani është një faktor i fuqishëm trazirash pushteti dhe politike.
Sistemi politik është i përkufizuar proporcionalisht qartë duke u ndarë ndërmjet përfaqësuesve të religjoneve të ndryshme, shpjegon eksperti Ernesti. Ndaj Vatikani e konsideron Libanin "si fushë eksperimentale për funksionimin e bashkëjetesës së njerëve të besimeve të ndryshme fetare". Nëse njerëzit në një "vend multireligjoz" nuk bashkëveprojnë, kjo çon në mungesë stabiliteti.

**Dear readers and followers of Argumentum.al**

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

***"Argumentum", an intellectual process…***

# "English Edition"

# Growth Plan 'Our Pathway to the EU': Western Balkans Leaders Advance Regional Integration in Tirana



TIRANA — Regional leaders gathered today (21.11) at the Palace of Brigades for the high-level Summit "Growth Plan: Our Pathway to the EU," reaffirming their joint commitment to accelerated reforms, deeper regional cooperation, and closer integration with the European Union. The event was opened by Albanian Prime Minister Edi Rama and EU Commissioner for Enlargement Marta Kos, who both underscored that the Western Balkans' future lies firmly within the European family.

The Summit, structured around two key discussion panels — "Shaping New Initiatives with Benefits for Citizens and Businesses" and "Delivering on Shared Commitments – Results and Acceleration" — is also launching the Regional Roadmap for the Western Balkans, addressing digital alignment, the region's role in the EU's AI ecosystem, improved border connectivity, tourism cooperation, and progress toward the Common Regional Market.

Rama: "Europe is not something we wait for — it is something we build."

In his opening remarks, Prime Minister Edi Rama emphasized a renewed spirit of unity and purpose in the region. Speaking to fellow leaders and EU partners, he highlighted that the Western Balkans are "moving forward together with a growth plan as our shared roadmap — not a roadmap to Brussels alone, but to the freedoms and opportunities of the European Single Market."

Rama outlined seven concrete advances already transforming the region:

**1. Ending EU–Western Balkans Roaming by 2026**

Building on the removal of internal WB roaming fees, Rama confirmed that negotiations to phase out roaming charges with the EU will begin in early 2026 — a change he described as "another artificial border eliminated."

**2. Full Acquis Alignment by 2026**

Albania, he stated, will complete alignment with the EU acquis by April 2026, marking another milestone following the adoption of SEPA, which has drastically reduced transaction costs across the region.

**3. Upgrading 16 Priority Border Crossings**

Through a new agreement with the European Commission and the World Bank, critical EU–WB and CEFTA border points will be modernized to reduce queues, improve logistics, and increase competitiveness.

**4. WiFi4WB: Bringing EU-Level Connectivity Across the Region**

A total of 394 municipalities have been selected to receive free public Wi-Fi networks beginning



this year — a tangible sign, Rama said, of "Europe felt in the everyday lives" of citizens.

**5. An Unprecedented Regional Reform Agenda**

More than 618 reform steps have been adopted under the Growth Plan, with 88% currently being implemented — spanning governance, rule of law, public finance, digitalization, and energy.

**6. Strategic Infrastructure Integration**

Major investment is flowing into critical corridors such as Corridor VIII, which now also serves NATO security priorities. Over €344 million is being directed to rail upgrades, alongside €112 million for new road infrastructure.

**7. The Western Balkans as Europe's "New Investment Frontier"**

Recent investment events have produced dozens of agreements and partnerships, demonstrating growing investor confidence.

"The Western Balkans are no longer Europe's problem," Rama declared. "We are Europe's opportunity."

Rama concluded with a confident message: "We are not entering the EU as beggars, but as contributors — to Europe's security, economy, and future."

Kos: "Europe cannot be secure without the Western Balkans."

EU Commissioner for Enlargement Marta Kos echoed Rama's tone, stressing the strategic importance of the region and Europe's readiness to accelerate integration.




Kos noted that while strong progress has been made, reform implementation remains uneven, with two Western Balkan partners yet to begin implementing the Growth Plan. She highlighted that only 10% of the available €1.6 billion has been disbursed so far and warned that nearly €300 million could be at risk if reforms due by June are not completed.

**Key priorities she outlined for the next two years include:**

- Faster reform adoption to unlock funding
- Advances in digital and energy market integration
- Improved transport links and tourism cooperation
- Accelerated preparation for participation in EU policies and the Single Market
- Stronger regional economic integration, which she said could add 10% growth to WB economies

> **Kos noted that while strong progress has been made, reform implementation remains uneven, with two Western Balkan partners yet to begin implementing the Growth Plan. She highlighted that only 10% of the available €1.6 billion has been disbursed so far and warned that nearly €300 million could be at risk if reforms due by June are not completed.**

Kos emphasized that all Western Balkan countries "belong fully and equally in the EU" and that integration must become a lived reality now — not only after accession.

"Your home, Europe, is waiting for you," Kos concluded. "Let us use the next two years to make the Growth Plan a success and to prepare the ground for your membership as equal states of the European Union."

A Critical Midpoint for the Growth Plan

With two years of the four-year Growth Plan completed, leaders agreed that the next phase must be marked by accelerated delivery, stronger coordination, and a clear focus on benefits felt directly by citizens and businesses.

From roaming-free communication and integrated digital identity to modernized borders and major infrastructure projects, the initiatives presented in Tirana signal that the Western Balkans' path to Europe is no longer an aspiration — but a practical, measurable process underway.

**EXCLUSIVE** / UKRAINIAN AMBASSADOR TO ALBANIA, VOLODYMYR SHKUROV:

# "Ukraine wants peace, but not at the expense of its freedom and independence"

By MARJANA DODA
EDITOR-IN-CHIEF

In an in-depth and wide-ranging interview with ARGUMENTUM.al, the Ambassador of Ukraine to Albania, H.E. Volodymyr Shkurov, reflects on the ongoing war in Ukraine, the country's diplomatic and military challenges, and its steadfast determination to defend sovereignty and pursue a just and lasting peace.

He also speaks about Kyiv's delicate diplomacy between the United States and the European Union, Albania's role as a reliable partner, and Ukraine's continued progress toward integration with the EU and NATO.



**"This year has been another major test for the Ukrainian people"**

According to Ambassador Shkurov, the year has been filled with enormous trials, but also meaningful achievements for Ukraine.

"This year has brought both significant accomplishments and heavy challenges. Among our achievements, I would mention the strengthening of international political support for Ukraine, progress in our path toward European integration, and the practical assistance of our partners in repelling the aggressor, which enables our Armed Forces to defend positions and conduct counteroffensive operations where appropriate."

He praised the courage and resilience of ordinary Ukrainians: "I would especially highlight the bravery of our soldiers, the selflessness of our emergency service workers, doctors, and ordinary citizens who, with integrity and conscience, continue their work in these difficult times for Ukraine."

Despite the suffering, he underlined that the country continues to function and reform.

"The European Commission, in its latest reports, recognizes real progress by Ukraine on its path to EU membership — a fact that gives us optimism despite the ongoing war."

**"The Trump–Putin meeting was a missed opportunity"**

Commenting on the much-discussed meeting between former U.S. President Donald Trump and Russian President Vladimir Putin, where the war in Ukraine was a key topic, Ambassador Shkurov said that such meetings carry potential but must include Ukraine to be effective.

"Any direct dialogue between leaders of states at war — or influencing it — has the potential to change the situation. However, the real result depends on transparency and, most importantly, on the willingness of the parties to compromise." "The meeting you mentioned between Presidents Trump and Putin ended without any concrete agreement on a ceasefire, and as a result, no roadmap with security guarantees for Ukraine was drawn up."

For Ukraine, Shkurov stressed, any peace that implies territorial concessions is unacceptable.

"A temporary ceasefire might have been possible, but pressure on Ukraine to make territorial concessions is unacceptable."

**"Ukraine maintains a delicate balance between the U.S. and the EU"**

Asked about differences between the U.S. and Europe in their approaches to the war, Ambassador Shkurov said Ukraine carefully balances its diplomacy to prevent rivalries among allies.

"Ukraine is fully aware of the importance of partnerships with both the United States and Europe. The U.S. provides critical defense technologies and political backing, while the EU, in addition to security assistance, provides large-scale financial and economic support, legal assistance, and tools essential for our European integration plans."

He emphasized that Ukraine seeks harmony, not competition, between its supporters:

"We aim to minimize any form of confrontation between these partners, demonstrating that a strong, democratic, and European Ukraine is a guarantee of stability for the entire continent and the transatlantic alliance."

**"European support is vital — but coordination must improve"**

Ambassador Shkurov described European support as "extraordi-

narily important."

"Sanctions, financial aid, arms deliveries, and humanitarian assistance — all these elements are vital for our resistance. Today, when the enemy is massively destroying Ukraine's energy systems, the support for our cities and villages is literally a matter of survival — water, heating, and electricity."

Yet he also noted that coordination must become more efficient: "We need clearer coordination, faster decision-making, and well-defined, long-term reconstruction plans."

He highlighted the importance of using frozen Russian assets for Ukraine's rebuilding: "The initiatives discussed at the EU and G7 levels for using frozen Russian assets as a source for Ukraine's reconstruction require clear legal and political implementation."

### "Ukraine will not surrender any territory — integrity is non-negotiable"

When asked if Ukraine might consider a peace deal that would include giving up occupied regions like Donbas, the ambassador was categorical:

"For Ukraine, territorial integrity is a fundamental principle. We do not regard giving up sovereignty or legitimizing annexations as an acceptable basis for peace."

He said Kyiv remains open to dialogue, but only within the framework of international law:

"Any peace agreement must be based on respect for internationally recognized borders and on security guarantees for our citizens."

### "Imposed neutrality contradicts our sovereign right"

Addressing Moscow's demand that Ukraine renounce its NATO aspirations and adopt neutrality, Ambassador Shkurov was equally firm:

"Any matter related to our national security must be decided solely by Ukraine itself, without external pressure. Our historical value lies in our right to independently choose the alliances to which we belong."

He added: "For us, what matters are not declarations of neutrality, but real security guarantees, which could be subject to negotiation — but only with Ukraine's participation and appropriate international control mechanisms."

### "EU and NATO integration remain strategic goals"

Despite the war, Ukraine continues to move closer to the EU and NATO, Ambassador Shkurov said.

"Ukraine has made noticeable progress in fulfilling the technical and legal requirements for European integration. The European Commission's latest reports acknowledge our reforms in the judicial system, anti-corruption efforts, and modernization of public administration."

Still, he admitted that the ongoing Russian aggression remains the main obstacle:

"War consumes vital resources and complicates our path to meeting NATO and EU standards. But the overall dynamic is positive, and steady international support remains decisive."

### "Albania is a steadfast and reliable friend of Ukraine"

The ambassador expressed sincere gratitude for Albania's consistent support since the beginning of the Russian invasion.

"Albania has been and remains a steadfast partner of Ukraine: from political declarations supporting our sovereignty and territorial integrity, to humanitarian aid and concrete steps taken within NATO and various regional initiatives."

He emphasized that the recent Security Cooperation Agreement between the two countries "confirms Tirana's readiness for long-term support," and he invited further collaboration: "Albania can continue contributing within NATO, support international initiatives on using frozen Russian assets for Ukraine's benefit, participate in educational and reconstruction projects, and help return kidnapped Ukrainian children deported to Russia."

### "Peace, yes — but not at any price"

Ambassador Shkurov insists that Ukraine will pursue peace only on just terms.

"Peace is our goal, but not peace at any price. Ukraine is ready for compromise only within limits that do not question our constitutional foundations or the security of our citizens."

Speaking both as a diplomat and as a citizen, he added emotionally: "I understand the pain of loss and, like every Ukrainian, I long for the war to end. However, no sacrifice can mean giving up our fundamental rights or our territorial integrity."

### "Do not let fatigue weaken your support for Ukraine"

Ambassador Shkurov concluded with a heartfelt message to both Ukrainians and the international community:

"The word 'support' must translate into concrete and swift actions to ensure effective protection of people, critical infrastructure, and the proper preparation for rebuilding the country."

To his fellow Ukrainians:

"Your courage, resilience, and determination remain the foundation of Ukraine's vitality — the guarantee of our victory. We must preserve unity, continue reforms even in wartime, and begin rebuilding wherever possible."

And to the world:

"I urge our partners not to allow support for Ukraine to fade due to fatigue. The decisions made today in the offices of our allies are vital — they save lives and determine the security of all Europe."

Read the full interview with the Ambassador of Ukraine to Albania, H.E. Volodymyr Shkurov, on ARGUMENTUM.al

# A trade ceasefire! Progress or regress reports? The mountainous road of negotiations 2027! Peace, not occupation and surrender for Ukraine

REAL POLITIK NO. 96 | 28 OCTOBER – 25 NOVEMBER 2025 | EXCLUSIVELY FOR ARGUMENTUM

**Comments " flash" on 4 major diplomatic events, only in 1.000 words by the well-known analyst, Grand Master in Diplomacy**

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*




## 1.

***A Trade Ceasefire*** was considered the much expected meeting on 30 October between US President, Trump and his chinese counterpart, Xi Jinping in Busan, South Korea. It occurred after serious clashes between them, threatening a world economic war with unpredictable effects. Trump's new economic policies and the high import duties applied against China and other states would undermine the world trade and economy, which even like this are full of tensions and conflicts.

But diplomacy and moderate attitudes by both countries avoided that war even though temporarily. Finally, they reached the deal and peace between the two states. After that China eased its export rules also for the EU. Although for a period of only one year but with an extension possibility.

In return, China did also ease its exports of rare earths, where it dictates the markets, which are defining for the economy, security, technology and defence of western countries.

However, caution is needed, since here it is not meant a genuine and lasting economic peace but simply a provisional but useful " trade ceasefire". Therefore, international diplomacy continues with persistence to work on finding a true and lasting tariff peace.

## 2.

***Progress or regress reports?*** This is the question arising after one reads the so-called " Progress Reports" that the EU Commission publicated and handed over on on 4th of November. It has become a tradition for years that on the eve of the end of a year, the EU Commission drafts and publishes such reports which indicate in concrete terms each country's progress in Western Balkans in all its vital areas. It is a careful scrutiny done by the immense corpus of EU economists.

However, the problem is that it has been years now that these reports with their synthetic indices instead of progress, they show much more regress in all countries of our region, without exception. Just have a look at them and you will note that they contain much more critical remarks and worrying problems than achievements. Our country too, despite achievements lacks much to be desired in many vital sectors; in particular in the fight againt organized crime and corruption, many critical remarks for the elections of 11 May 2025 with several irregularies and others. Hence, it has been correctly suggested that instead of the" progress" to find a more proper name for this basic European document. Moreover that the EU Member States and Parliament, when they review these reports, they are likely to add other politi-



cal remarks and criticism.

## 3.

***"The montaineous road" of negotiations 2027!***

On 17 November, the opening of the Fifth Cluster in Brussels marked the opening of all 33 chapters of negotiations for our EU accession. This is an important moment which deserves to be greeted. However, in real terms this means that " honeymoon with the EU is over" and now we have two years of work and challenges. Moreover, if until now we were driving in a field road, in the remaining 24 monrths we hav to climb a mountainous road with plenty of strong turning points.

The good news is that we have produced several signififacant advantages to date. Thus, Albania has the largest support in the region on EU membership; we have acquired a great experience in the last 11 years after gaining the EU candidate status; there is an efficient, experienced and well-qualified team of negotiators in place, we have an efficient diplomatic service, especially our Diplomatic Mission to the EU in Brussels; a very important factor is the Assembly's contribution whose work in the legislation approximation and in supervising the EU processes which is internationally recognized.

Abroad, apart from the favourable geopolitical factor we have a much more positive image thanks also to some appreciated steps in the diplomatic area, EU and regional summits in Tirana and others. Likewise, in principle we enjoy the political, economic and financial support by al EU Member States, the Commission and thee EU Parliament. Then, unlike before, the EU Enlargement



Strategy permits us to conclude simultaneously some or even all the negotation clusters.

Meanwhile, caution is needed to avoid the minuses and well-known problematics; for if they are not solved or eliminated, may diminish and even devaluate the above-mentioned achievements and advantages. They are reflected in all official EU and OSCE documents; they were also mentioned at the presence of PM Rama in Brussels on 4 and 17 November also by EU Commissioner, Marta Kos: election irregularities in the elections on 11 May which are mentioned in the Progress Report 2025 the Electoral Reform, dialogue with opposition, the state behaviur vs the media and civil society, judiciary independence, the principle of the division of powers, the autonomy of local government, transparency with public funding, fight against crime and corruption and others. Well, when we work out all these problematics, one can see the " high mountain" of work we have to climb until 2027 in our hard road of the said negotiations.

## 4.

**Peace, no occupation and surrender for Ukraine!** We have followed during the last 10 days the extensive diplomatic talks and demarshes in Geneve, Brussels, Kiev, Uashington and elsewhere in Europe in an effort to draft a plan that would would be totally different from the US 28 point Peace Plan of 20 November. Europe and Kiev reacted again rapidly and are doing everything possible for a new deal on an ceasefire and then a genuine and lasting peace in Ukraine. A peace on the basis of international law, not imposed from the position of strength, not by changing borders with arms, a peace in which Ukraine would retain its sovereignty and territorial integrity, with its own powerful army, with its own will for EU and NATO accession and with the support of its own allies. In short, we need peace and not a new occupation, surrender and humiliation of Ukraine and of Europe. A peace that makes a diference between the victim and aggressor, the latter to be punished and not rewarded.

However, given the Russian geostrategic ambitions to reestablish the former Soviet empire, this peace deal would be extremely difficult, not to say impossible without fighting to the end. If you want peace, prepare for war, this remains the best alternative for a genuine an sustainable peace.

ARGUMENTUM

news opinion analysis

Adresa:  Njësia bashkiake nr. 5, Rruga “Abdyl Frasheri”, Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

Email:  redaksia.argumentum@gmail.com,

info@argumentum.al

NUIS/NIPT: L91415033Q

Twiter : Argumentum_al

Facebook: argumentum.al

Instagram: argumentumnews

© Argumentum. All rights reserved